REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

RREGULLORE

PËR

CAKTIMIN DHE PËRDORIMIN E BURIMEVE TË NUMERACIONIT

Dokument për Këshillim Publik

Miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues (VKD) të AKEP, nr. 29, datë 06.11.2026

PËRMBLEDHJE

KAPITULLI I 6
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME 6
Neni 1 6
Baza ligjore 6
Neni 2 6
Qëllimi 6
Neni 3 6
Objektivat 6
Neni 4 7
Përkufizime 7
Neni 5 10
Ndërveprimi 10
Neni 6 10
Identifikimi i linjës thirrëse dhe të thirrur 10
KAPITULLI II 12
ADMINISTRIMI I BURIMEVE TË NUMERACIONIT 12
Neni 7 12
Parimet 12
Neni 8 12
Kushtet për përdorimin e burimeve të numeracionit ..... **Error! Bookmark not defined.**
Neni 9 13
Caktimi i burimeve të numeracionit 13
Neni 10 14
Aplikimi për caktimin e burimeve të numeracionit 14
Neni 11 16
Vlefshmëria e Autorizimit 16
Neni 12 16
Transferimi 16
Neni 13 17
Revokimi dhe pezullimi i caktimit të numrave 17
Neni 14 18
Detyrimet e mbajtësve të së drejtës së përdorimit të numrave 18
Neni 15 18
Detyrimet e AKEP 18
Neni 16 19
Miratimi i numeracionit 19

Neni 17 ..... **Error! Bookmark not defined.**
Statistikat për përdorimin e numrave ..... **Error! Bookmark not defined.**
Neni 18 19
Publikimi 19
Neni 19 20
Pagesat vjetore për caktimin e burimeve të numeracionit 20
KAPITULLI III 21
PLANI KOMBËTAR I NUMERACIONIT 21
Neni 20 21
Struktura e Planit Kombëtar të Numeracionit 21
Neni 21 22
Plani i numërformimit 22
Neni 22 22
Kodet e aksesit dhe kodet e shkurtër 22
Neni 23 24
Numri i emergjencës 112 24
Neni 24 25
Numrat e harmonizuar për shërbimet sociale 116 $X_1X_2X_3$ 25
Neni 25 27
Numrat e shërbimit të informacionit telefonik 118X_1X_2 27
Neni 26 27
Numrat e shkurtër për shërbimet e operatorit të rrjetit 27
Neni 27 28
Numrat gjeografikë 28
Neni 28 29
Numra jogjeografikë për shërbime të komunikimeve elektronike që ofrohen në vendndodhje të lëvizshme 29
Neni 29 30
Numrat jo gjeografik për ofruesit MVNO 30
Neni 30 31
Numra jogjeografikë për shërbime të komunikimeve elektronike, të ndryshme nga shërbimet e komunikimeve ndërpersonale 31
Neni 31 32
Numrat personal/ nomadë (700$X_1X_2X_3X_4X_5$) 32
Neni 32 32
Numrat e gjelbërt (800$X_1X_2X_3X_4$) 32
Neni 33 32

Numrat për kartat telefonike (801$X_1X_2X_3$) 32
Neni 34 33
Numrat blu (808$X_1X_2X_3$) 33
Neni 35 33
Numrat për shërbimet me vlerë të shtuar (900$X_1X_2X_3$) 33
Neni 36 33
Numrat e shkurtër për shërbimet SMS me vlerë të shtuar (5$X_1X_2X_3X_4$) 33
Neni 37 33
Rregulla për shërbimet me vlerë të shtuar 33
Neni 38 34
Prefiksi për zgjedhjen e bartësit (10X_1X_2) 34
Neni 39 35
Prefikset e rrugëzimit për portabilitetin e numrit (99X_1X_2) 35
KAPITULLI IV 35
PLANET E TJERA NUMERIKE 35
Neni 40 35
Formati dhe kapaciteti i numrave NSPC dhe ISPC 35
Neni 41 36
Caktimi i Kodeve të Pikave të Sinjalizimit 36
Neni 42 37
Kriteret e vlerësimit të Kodeve të Pikave të Sinjalizimit 37
Neni 43 37
Revokimi i Kodeve të Pikave të Sinjalizimit 37
Neni 44 38
Kodet e rrjeteve mobile 38
Neni 45 39
Kodet Identifikuese IIN (Issuer Identifier Numbers) 39
KAPITULLI V 39
DISPOZITA KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE 39
Neni 46 39
Përputhshmëria me Planin e Numeracionit 39
Neni 47 39
Hyrja në fuqi 39
SHTOJCA I: ZONAT GJEOGRAFIKE 40
SHTOJCA II: FORMULARËT E APLIKIMIT 44
Formular Aplikimi për caktimin e numrave dhe serive numerike 44

Formular Aplikimi Caktimi i Kodit të Pikës Kombëtare të Sinjalizimit (NSPC) 50
Formular Aplikimi Caktimi i Kodit të Pikës Ndërkombëtare të Sinjalizimit (ISPC) 52
Formular Aplikimi Caktimi i Kodeve MCC MNC (ITU-T E.212) 54
Formular Aplikimi Caktimi i Kodeve IIN (ITU-T E.118) 55
SHTOJCA III: FORMA E AUTORIZIMIT 57
SHTOJCA IV: PROCEDURA PËR DHËNIEN NË PËRDORIM TË NUMRIT TË SHKURTËR KOMBËTAR PËR SHËRBIMET SOCIALE TË HARMONIZUARA 73
SHTOJCA V: PLANI I PËRDORIMIT TË NUMERACIONIT 75

KAPITULLI I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Baza ligjore

Kjo rregullore është hartuar në zbatim të neneve 131 deri 136 të Kreut XVII "Burimet e numeracionit", të ligjit nr. 54/2024 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë".

Neni 2
Qëllimi

1. Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i strukturës dhe gjatësisë së burimeve të numeracionit, si dhe procedurave për dhënien, ndryshimin, transferimin, pezullimin dhe revokimin e të drejtave të përdorimit të tyre për rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike publike të ofruara në Republikën e Shqipërisë.

2. Rregullorja është hartuar bazuar në rekomandimet/udhëzimet/dokumentat si më poshtë:
   a) Rekomandimin ITU-T E.164 (Planin e Numeracionit për shërbimet e telefonisë),
   b) Rekomandimin ITU-T E.212 (Planin e Identifikimit për rrjetet dhe shërbimet publike të lëvizshme),
   c) Rekomandimin ITU-T Q.708 (Kodet e Pikave të Sinjalizimeve Ndërkombëtare (ISPC) dhe Kodet e Pikave të Sinjalizimeve Kombëtare (NSPC),
   d) Rekomandimin ITU-T E.118 Kodet IIN (Issues Identifiers Number),
   e) Plani i Numeracionit për shërbimet e mesazheve të shkurtra me vlerë të shtuar (SMS VAS
   f) Udhëzimin e BEREC BoR (20) 50, datë 6 mars 2020, "Mbi kriteret e përbashkëta për vlerësimin e aftësisë së sipërmarrjeve të ndryshme nga ofruesit e rrjeteve ose shërbimeve të komunikimeve elektronike për administrimin e burimeve të numeracionit dhe të rrezikut të shterimit të tyre

Neni 3
Objektivat

1. Kjo rregullore ka për objektiv të përcaktojë parimet dhe kërkesat për administrimin, caktimin dhe përdorimin e burimeve të numeracionit, me qëllim:
   a) Sigurimin e administrimit dhe përdorimit efikas, racional dhe të qëndrueshëm të burimeve të numeracionit, në përputhje me nevojat aktuale dhe zhvillimet e ardhshme të tregut të komunikimeve elektronike;
   b) Sigurimin e përmbushjes së nevojave të arsyeshme për burime numeracioni të operatorëve dhe ofruesve të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike të disponueshme për publikun, si dhe të sipërmarrjeve të tjera që kanë të drejtë të përdorin këto burime, në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi;

c) Sigurimin e procedurave objektive, transparente, proporcionale dhe jodiskriminuese për caktimin dhe përdorimin e burimeve të numeracionit, duke garantuar trajtim të barabartë për subjektet që plotësojnë kushtet për përfitimin e të drejtave të përdorimit;
d) Garantimin e zbatimit të parimit të neutralitetit teknologjik në administrimin dhe përdorimin e burimeve të numeracionit, në përputhje me kërkesat teknike dhe rregullatore të zbatueshme;
e) Mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të përdoruesve fundorë, duke siguruar përdorimin e duhur të burimeve të numeracionit dhe aksesin në shërbimet e komunikimeve elektronike.

Neni 4
Përkufizime

Në këtë rregullore termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

1. **"Facilitete shoqëruese"** janë ato shërbime shoqëruese, infrastruktura fizike dhe facilitete të tjera ose elemente të lidhura me një rrjet të komunikimeve elektronike ose një shërbim të komunikimeve elektronike, të cilat mundësojnë ose mbështesin ofrimin e shërbimeve nëpërmjet këtij rrjeti ose shërbimi apo kanë potencial për ta bërë këtë e që përfshijnë, ndërmjet të tjerash, ndërtesat ose hyrjen në ndërtesa, kabllot e ndërtesave, antenat, kullat dhe ndërtime të tjera mbështetëse, kanalizime, tubacione, shtylla, puseta dhe kabinete.
2. **"Identifikimi i linjës thirrëse"** është funksioni që, në bazë të numrit ose kodit të caktuar për pikën fundore të rrjetit, i mundëson pajtimtarit marrës të thirrjes të identifikojë pikën fundore të rrjetit, ku është origjinuar thirrja.
3. **"Kodi Kombëtar i Drejtimit"(National Destination Code-NDC)** është një numër apo një kombinim numrash pa prefiksin kombëtar "0", i cili karakterizon zonën e numeracionit të thirrur. Nëse plani kombëtar i numeracionit është "i hapur" dhe kur pajtimtari thirrës dhe ai i thirrur u përkasin zonave të ndryshme të numeracion-it, ky kod formohet përpara numrit të pajtimtarit të thirrur. Për rrjetet e lëvizshme të komunikimeve publike në këtë rast përdoret termi "Kodi i Drejtimit të Rrjetit".
4. **"Kodi i shkurtër"** do të thotë një numër me tre deri gjashtë shifra.
5. **"Kod numeracioni"** është një numër apo një kombinim numrash pa prefiksin kombëtar "0", i cili karakterizon zonën e numeracionit të thirrur. Nëse plani kombëtar i numeracionit është "i hapur" dhe kur pajtimtari thirrës dhe ai i thirrur u përkasin zonave të ndryshme të numeracionit, ky kod formohet përpara numrit të pajtimtarit të thirrur.
6. **"Kod i Pikës së Sinjalizmit (SPC)"** është një kod i përdorur për të identifikuar një pikë sinjalizimi. SPC përdoren për të adresuar pikat e sinjalizmit në rrjetet e sinjalizimit bazuar në Sistemin e Sinjalizimit ITU-T Nr.7 (SS7).
7. **"Kodi i Pikës së Sinjalizimit Ndërkombëtar (ISPC)"** është një kod pike sinjalizimi me format përdorimi unik 14 bit në nivel ndërkombëtar për rrugëzimin e mesazheve të sinjalizimit dhe identifikimin e pikave të sinjalizmit të përfshira. ISPC përdoret në mesazhet e sinjalizimit duke përmbajtur Treguesin e Rrjetit NI (Network Identifier) = 00
8. **"Marrëdhënie sinjalizimi"** është një lidhje midis dy pikave të sinjalizmit që lejon shkëmbimin e mesazheve të sinjalizimit Nr.7.

9. **“Numër”** është një seri alfa-numerike e përcaktuar në planin e numeracionit, që shërben për adresim në rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike.
10. **“Numërformimi “00””** është kodi standard ndërkombëtar i aksesit. Për përdorimin e shërbimeve të komunikimit ndërpersonal bazuar në numra, ndërmjet vendndodhjeve gjeografike të afërta midis vendeve e përgjatë kufirit nënshkruhen marrëveshje të veçanta.
11. **“Numër gjeografik”** është një numër nga plani kombëtar i numeracionit, ku një pjesë e strukturës së tij shifrore përmban domethënie gjeografike, të përdorur për drejtimin e thirrjeve në vendndodhjen fizike të pikës fundore të rrjetit në një rajon gjeografik të caktuar.
12. **“Numrat jogjeografikë”** janë numrat nga plani kombëtar i numeracionit, që nuk i përkasin një rajoni gjeografik të caktuar dhe përfshijnë:
    a. numrat për akses në rrjetet publike të lëvizshme të komunikimit;
    b. numrat për akses në shërbimet me vlerë të shtuar, numrat me tarifë premium;
    c. numrat për akses në shërbimet për të cilat e gjithë tarifa për trafikun drejt këtyre shërbimeve paguhet nga ofruesi i shërbimeve, pra drejt numrave që janë pa pagesë për përdoruesit;
    d. numrat për akses në shërbimet për të cilat tarifa për trafikun drejt këtyre shërbimeve paguhet pjesërisht nga thirrësi dhe pjesërisht nga ofruesi i shërbimit, pra drejt numrave, të cilët i janë dhënë përdoruesit përkundrejt një marrëdhënieje të paracaktuar, numra me ndarje të kostos ose numër blu;
    e. numrat për shërbim publik telefonik nomadik.
13. **“Numrat ndërkombëtarë universalë pa pagesë (UIFN)”** janë numrat 800 pa pagesë në mbarë botën, të caktuara nga Bashkimi Ndërkombëtar i Telekomunikacionit.
14. **“Numër kombëtar”** do të thotë një numër i planit kombëtar të numeracionit të Republikës së Shqipërisë sic përkufizohet në kapitullin 2 të kësaj rregulloreje.
15. **“Numrat e shërbimeve të emergjencës”** janë numrat e përcaktuar në planin kombëtar të numeracionit për shërbimet e emergjencës për policinë, zjarrfikësit, numrat e emergjencës për shërbimet shëndetësore, shërbimet lajmëruese dhe ato të deklaruara, përfshirë numrin e unifikuar evropian të thirrjeve të emergjencës “112”.
16. **“Ofruesi i shërbimit të komunikimeve publike”** është sipërmarrësi që ofron shërbime komunikimi publike, duke siguruar akses te një operator i rrjetit të komunikimeve publike.
17. **“Operator”** është një sipërmarrës që ofron ose që është i autorizuar të ofrojë një rrjet të komunikimeve elektronike ose faciliteteve shoqëruese.
18. **“Pajtimtar”** është cilido që ka lidhur një kontratë me një sipërmarrës që ofron shërbime të komunikimeve elektronike, të disponueshme për publikun, për përfitimin e shërbimeve të ofruara.
19. **“Pika fundore e rrjetit”** është pika fizike në të cilën një përdorues fundor ka akses në rrjetin e komunikimeve elektronike publike. Në rastin e rrjeteve që përfshijnë komutimin ose rrugëzimin, pika fundore e rrjetit identifikohet si një adresë specifike e rrjetit, e cila mund të lidhet me numrin ose emrin e një përdoruesi fundor.
20. **“Pikë sinjalizimi (SP)”** është një nyje në një rrjet sinjalizimi që origjinon dhe merr mesazhe sinjalizimi, ose transferon mesazhe sinjalizimi nga një link sinjalizimi në një tjetër, ose të dy.
21. **“Pjesa e Transferimit te Mesazheve (Message Transfer Part - MTP)”** është pjesë e Sistemit të Sinjalizimit 7 (SS7) e përdorur për komunikim në rrjetet publike të komunikimit. Është përgjegjëse për besueshmërinë e mosduplikimit dhe transportin në

sekuencë të mesazheve SS7 midis rrjeteve komunikues. Sëbashku me testet është e përcaktuar në rekomandimet e ITU-së.

22. **"Plani i numeracionit"** është struktura e numrave dhe e serive të numrave, si dhe caktimi i tyre për sigurimin e aksesit në rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike publike.
23. **"Plani i numër-formimit"** do të thotë rregullat se si mund të thirren numrat e planit të numeracionit në rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike.
24. **"Rrjet i komunikimeve elektronike"** janë sistemet e transmetimit, të bazuara ose jo mbi një infrastrukturë të përhershme ose mbi kapacitete administrimi të qendërzuar dhe, kur është e aplikueshme, sistemet e komutimit ose rrugëzimit dhe burime të tjera, përfshirë elementet e rrjetit që nuk janë aktive, të cilat lejojnë përcjelljen e sinjaleve nëpërmjet përcjellësve, radios, mjeteve optike ose mjeteve të tjera elektromagnetike, duke përfshirë rrjetet satelitore, rrjetet fikse tokësore, me komutim të qarqeve ose me komutim të paketave, përfshirë internetin, rrjetet e lëvizshme tokësore, sistemet e kabllove elektrike, në raste kur ato përdoren për transmetimin e sinjaleve, rrjetet e përdorura për transmetimet radiotelevizive dhe rrjetet kabllore televizive, pavarësisht nga tipi i informacionit që përcjell.
25. **"Rrjet i komunikimeve publike"** është një rrjet i komunikimeve elektronike, që përdoret tërësisht ose kryesisht për ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike, të disponueshme për publikun dhe që mbështet transferimin e informacionit ndërmjet pikave fundore të rrjetit.
26. **"Seri Numerike"** nënkupton një grup numrash që fillon me të njëjtat shifra, në veçanti, një grup prej 1000 ose 10000 numrash.
27. **"Sipërmarrës"** është çdo person fizik ose juridik i regjistruar sipas legjislacionit në fuqi, i cili ofron rrjete të komunikimeve elektronike ose shërbime të komunikimeve elektronike.
28. **"Shërbim i komunikimeve elektronike"** është shërbimi i kryer kundrejt një pagese, i përftuar nëpërmjet rrjetit të komunikimeve elektronike, i cili, duke përjashtuar shërbimet që ofrojnë ose ushtrojnë kontroll redaksional ndaj përmbajtjes së transmetuar, duke përdorur rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike, përfshin llojet e mëposhtme të shërbimeve:
    a. "Shërbim aksesi në internet" është shërbimi i komunikimit elektronik, i disponueshëm për publikun, që ofron akses në internet dhe në këtë mënyrë lidhje me pothuajse të gjitha pikat fundore virtuale të internetit, pavarësisht nga teknologjia e rrjetit dhe pajisjet fundore të përdorura;
    b. "Shërbim i komunikimit ndërpersonal" është shërbimi i ofruar normalisht kundrejt një pagese, që mundëson shkëmbimin e drejtpërdrejtë ndërpersonal dhe ndërveprues të informacionit, nëpërmjet rrjeteve të komunikimeve elektronike, ndërmjet një numri të kufizuar personash, ku personat që iniciojnë ose marrin pjesë në komunikim përcaktojnë marrësit e tij. Ky shërbim nuk përfshin shërbimet që mundësojnë komunikimin ndërpersonal dhe ndërveprues, thjesht si një veçori ndihmëse e vogël, e lidhur në mënyrë të brendshme me një shërbim tjetër;
    c. shërbimet që konsistojnë tërësisht ose kryesisht në përcjelljen e sinjaleve të tilla, si shërbime transmetimi që përdoren për ofrimin e komunikimeve makinë – makinë dhe për transmetime radiotelevizive.
29. **"Shërbim i komunikimit ndërpersonal i bazuar në numër"** është një shërbim komunikimi ndërpersonal, i cili lidhet me burimet e numeracionit të caktuara publikisht, sikurse me një numër ose me numra të planit kombëtar ose ndërkombëtar të numeracionit,

që mundëson komunikimin me një numër tjetër ose numra të planit kombëtar ose ndërkombëtar të numeracionit.

30. **"Shërbim me vlerë të shtuar"** është një shërbim informacioni, i ofruar përmes numrave me tarifë premium, me ndarje kostosh ose numrave të gjelbër, nëpërmjet rrjetit publik të komunikimeve elektronike, normalisht përkundrejt një pagese.
31. **"Tregues rrjeti (NI- Network Indicator)"** bën dallimin midis tipeve të ndryshme të adresave për pikat e sinjalizmit.
32. **"Zonë numeracioni gjeografike"** është një rajon gjeografik i përcaktuar, i cili ka një kod të caktuar numeracioni.

Neni 5
Ndërveprimi

1. Të gjithë operatorët e rrjeteve dhe ofruesit e shërbimeve të komunikimeve elektronike të disponueshme për publikun, si dhe sipërmarrjet e tjera që përdorin numra dhe seri numerike të Planit Kombëtar të Numeracionit, duhet të garantojnë ndërveprueshmërinë e shërbimeve dhe mundësinë e komunikimit ndërmjet përdoruesve. Në këtë kuadër, përdoruesve të cilëve u është caktuar një numër nga Plani Kombëtar i Numeracionit duhet t'u mundësohet, në përputhje me natyrën dhe karakteristikat e shërbimit të ofruar, kryerja e thirrjeve drejt numrave të tjerë të këtij plani, si dhe kryerja dhe marrja e thirrjeve ndërkombëtare, në përputhje me legjislacionin dhe kushtet rregullatore në fuqi.

2. Operatorët dhe ofruesit e shërbimeve të komunikimeve elektronike mund të zbatojnë kufizime në mundësinë e kryerjes ose marrjes së thirrjeve drejt ose nga numra apo seri të caktuara numerike, kur këto kufizime kërkohen nga vetë përdoruesit, në përputhje me kushtet e ofrimit të shërbimit dhe legjislacionin në fuqi.

Neni 6
Identifikimi i linjës thirrëse dhe të thirrur

1. Identifikimi i linjës thirrëse ofrohet në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale dhe të privatësisë, si dhe me dispozitat e Kreut XIX të ligjit nr. 54/2024, "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë". Operatorët e rrjeteve dhe ofruesit e shërbimeve të komunikimeve elektronike duhet të sigurojnë, për aq sa është teknikisht e mundur, transmetimin e të dhënave dhe informacionit të nevojshëm të sinjalizimit, me qëllim mundësimin e identifikimit të linjës thirrëse, përfshirë thirrjet ndërkombëtare ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe shteteve të tjera.

2. Operatorët ose ofruesit e rrjeteve publike të komunikimit, që ofrojnë identifikimin e linjës thirrëse, janë të detyruar t'i mundësojnë dërguesit të thirrjes që para çdo thirrjeje të ketë mundësi të fshehë identifikimin e thirrjes së tij në mënyrë të thjeshtë dhe pa pagesë. Ofruesit e shërbimeve publike të komunikimeve detyrohen të sigurojnë për pajtimtarët e tyre parandalimin e identifikimit të të gjitha thirrjeve në linjat e tyre në mënyrë automatike dhe pa pagesë.

3. Operatorët dhe ofruesit e shërbimeve të rrjeteve publike të komunikimit, nuk do të respektojnë detyrimet që rrjedhin nga pika 2 e këtij neni vetëm për thirrjet drejt shërbimeve të emergjencës.

4. Operatorët dhe ofruesit e shërbimeve të rrjeteve publike të komunikimit, që ofrojnë identifikimin e thirrjeve, janë të detyruar t'i mundësojnë marrësit të thirrjeve të mos identifikojë dërguesin e thirrjeve, përpara çdo thirrjeje, në mënyrë të thjeshtë dhe pa pagesë.

5. Në rast se operatorët dhe ofruesit e shërbimeve të rrjeteve publike të komunikimit ofrojnë identifikimin e linjës së thirrur dhe identifikimi është i mundur para se të fillojë komunikimi, pajtimtari i thirrur duhet të ketë mundësi që, në mënyrë të thjeshtë dhe pa pagesë, të refuzojë të gjitha thirrjet hyrëse, për të cilat dërguesi i thirrjes ka parandaluar identifikimin e linjës thirrëse.

6. Nëse një operator ose ofrues i shërbimeve të rrjeteve publike të komunikimit ofron identifikimin e linjës thirrëse, ai është i detyruar t'i mundësojë përdoruesit të thirrur të përdorë parandalimin e identifikimit të linjës së lidhur me përdoruesin thirrës, në mënyrë të thjeshtë dhe pa pagesë.

7. Në rast se një pajtimtar kërkon me shkrim që operatori të gjurmojë thirrjet keqdashëse, operatorët dhe ofruesit e shërbimeve të rrjeteve publike të komunikimit, përkohësisht, mund të regjistrojnë origjinën e të gjitha thirrjeve që përfundojnë në pajisjen fundore të pajtimtarit, përfshirë edhe ato për të cilat ka pasur një kërkesë për fshehjen e identifikimit.

8. Të dhënat për gjurmimin duhet të ruhen dhe trajtimi i mëtejshëm i tyre nga sipërmarrësi bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

9. Operatorët dhe ofruesit e shërbimeve të rrjeteve publike të komunikimit janë të detyruar që në kushtet e përgjithshme të kontratës së pajtimtarit të parashikojnë mundësinë e paraqitjes dhe të parandalimit të identifikimit të linjës së thirrur dhe asaj thirrëse.

10. Operatorët dhe ofruesit e rrjeteve publike të komunikimit sigurojnë që identifikimi i linjës thirrëse të përmbajë një numër të caktuar, të formatuar saktë dhe të telefonueshëm, për të cilin pala thirrëse ose përdoruesi ka të drejtën e përdorimit, në përputhje me legjislacionin dhe aktet rregullatore në fuqi.

11. Numrat dhe seritë numerike të përcaktuara në Planin Kombëtar të Numeracionit për ofrimin e shërbimeve me tarifë të posaçme nuk lejohen të përdoren për identifikimin e linjës thirrëse (CLI), përveç rasteve kur një përdorim i tillë parashikohet shprehimisht në legjislacionin ose aktet rregullatore në fuqi.

KAPITULLI II
ADMINISTRIMI I BURIMEVE TË NUMERACIONIT

Neni 7
Parimet

1. Administrimi, caktimi dhe përdorimi i burimeve të numeracionit kryhen në përputhje me legjislacionin dhe aktet rregullatore në fuqi, duke u mbështetur në parimet e mëposhtme:

    a. Objektiviteti dhe transparenca, duke garantuar që procedurat dhe kriteret për caktimin e të drejtave të përdorimit të burimeve të numeracionit të jenë të qarta, të përcaktuara paraprakisht dhe të zbatohen në mënyrë të paanshme;
    b. Mosdiskriminimi dhe trajtimi i barabartë, duke siguruar kushte të barabarta për të gjitha subjektet që plotësojnë kriteret për përfitimin e të drejtave të përdorimit të burimeve të numeracionit;
    c. Proporcionaliteti, duke garantuar që kushtet dhe detyrimet e vendosura për përdorimin e burimeve të numeracionit të jenë të përshtatshme dhe të mos tejkalojnë atë që është e nevojshme për arritjen e objektivave rregullatore;
    d. Përdorimi efikas dhe racional i burimeve të numeracionit, duke siguruar administrimin e qëndrueshëm të tyre, shmangien e përdorimit të panevojshëm dhe disponueshmërinë e burimeve për nevojat aktuale dhe të ardhshme të tregut;
    e. Neutraliteti teknologjik, duke garantuar që administrimi dhe përdorimi i burimeve të numeracionit të mos kufizohet në teknologji të caktuara, përveç rasteve kur kufizimet justifikohen nga kërkesat teknike ose rregullatore të zbatueshme;
    f. Përdorimi në përputhje me destinacionin, duke siguruar që burimet e numeracionit të caktohen dhe të përdoren në përputhje me strukturën, kategoritë dhe destinacionin e përcaktuar në Planin Kombëtar të Numeracionit;
    g. Mbrojtja e interesave të përdoruesve fundorë, duke garantuar që administrimi dhe përdorimi i burimeve të numeracionit të mbështesë aksesin në shërbimet e komunikimeve elektronike dhe mbrojtjen e të drejtave të përdoruesve;
    h. Nxitja e konkurrencës dhe inovacionit, duke mundësuar aksesin në burimet e numeracionit për subjektet që plotësojnë kriteret ligjore dhe rregullatore, si dhe duke mbështetur zhvillimin e shërbimeve të reja të komunikimeve elektronike.

Neni 8
Kushtet për të drejtat e përdorimit të burimeve të numeracionit

1. Të drejtat e përdorimit të burimeve të numeracionit jepen nga AKEP në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe Planin Kombëtar të Numeracionit. Përveç kushteve të zbatueshme sipas regjimit të autorizimit të përgjithshëm, këto të drejta mund t'u nënshtrohen kushteve të mëposhtme, sipas natyrës dhe destinacionit të burimeve të numeracionit:
    a. Burimet e numeracionit të përdoren vetëm për shërbimet dhe qëllimet për të cilat janë caktuar, në përputhje me Planin Kombëtar të Numeracionit dhe kushtet e përcaktuara në të drejtën përkatëse të përdorimit;

b. Të sigurohet përdorimi racional dhe efektiv i burimeve të numeracionit, duke shmangur mbajtjen e pajustifikuar të numrave ose serive numerike të papërdorura;
c. Të zbatohen kërkesat teknike për strukturën, formatin, gjatësinë dhe përdorimin e numrave, në përputhje me Planin Kombëtar të Numeracionit dhe standardet ndërkombëtare të zbatueshme;
d. Të sigurohet zbatimi i detyrimeve për portabilitetin e numrave, për kategoritë e numeracionit për të cilat kjo kërkesë është e zbatueshme, në përputhje me legjislacionin dhe aktet rregullatore në fuqi;
e. Të sigurohet mundësia e aksesit dhe komunikimit ndërmjet përdoruesve të rrjeteve dhe shërbimeve të ndryshme të komunikimeve elektronike, në përputhje me natyrën e shërbimit dhe kërkesat rregullatore të zbatueshme;
f. Të respektohen kërkesat për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të përdoruesve fundorë, përfshirë, sipas rastit, transparencën e tarifave dhe zbatimin e tarifave maksimale për kategori të caktuara numeracioni;
g. Të përmbushen detyrimet për vënien në dispozicion të informacionit për shërbimet e numëratorit telefonik, në përputhje me nenin 152 të ligjit nr. 54/2024 dhe legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale;
h. Transferimi i të drejtave të përdorimit të burimeve të numeracionit të kryhet vetëm në përputhje me kushtet dhe procedurat e përcaktuara në legjislacionin dhe aktet rregullatore në fuqi, duke siguruar respektimin e kushteve që shoqërojnë këto të drejta;
i. Të përmbushen detyrimet për pagesat që lidhen me të drejtat e përdorimit të burimeve të numeracionit, në përputhje me nenin 22 të ligjit nr. 54/2024 dhe aktet përkatëse në fuqi;
j. Të respektohen angazhimet e ndërmarra nga mbajtësi i të drejtave të përdorimit gjatë procedurave konkurruese ose krahasuese për caktimin e burimeve të numeracionit, kur këto procedura janë të zbatueshme;
k. Të respektohen detyrimet që rrjedhin nga marrëveshjet ndërkombëtare të zbatueshme për përdorimin e burimeve të numeracionit;
l. Të paraqiten pranë AKEP-it, sipas kërkesave dhe procedurave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi, të dhënat dhe informacioni i nevojshëm për verifikimin e respektimit të kushteve të përdorimit të burimeve të numeracionit.

2. Mbajtësit e të drejtave të përdorimit të burimeve të numeracionit janë përgjegjës për respektimin e kushteve të përcaktuara në Autorizimin e lëshuar nga AKEP për caktim dhe përdorim të burimeve të numeracionit, gjatë gjithë periudhës së vlefshmërisë së tyre.

Neni 9
Caktimi i burimeve të numeracionit

1. Dhënia e së drejtës për të përdorur numra nga plani i numeracionit caktohet nëpërmjet dy metodave:
   a. Caktimi i drejtpërdrejtë: AKEP cakton numra individualë për përdoruesit, ose
   b. Caktimi sipas procesit të alokimit parësor dhe dytësor: AKEP cakton blloqe numrash në procesin e alokimit parësor (primary alocation) për operatorin e rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve eletronike publike dhe këta operatorë caktojnë numra

individualë në procesin e alokimit dytësor (second alocation) për pajtimtarët e tyre.

2. Numrat gjeografike, numrat e lëvizshëm dhe numrat personale caktohen sipas procesit të alokimit parësor dhe dytësor. Vetëm operatori i rrjeteve publike të komunikimeve elektronike mund të aplikojë për numra që caktohen sipas procesit të alokimit parësor.

3. Numrat e urgjencës, numrat për shërbimet sociale të harmonizuara, numrat për shërbimet e informacionit, numrat e gjelbër, numrat për kartat telefonike, numrat blu, numrat për shërbimet me vlerë të shtuar, kodet e shkurtra për shërbimet SMS me vlerë të shtuar dhe kodet e shkurtra të harmonizuara evropiane (HESC) caktohen drejtpërdrejt për ofruesit e këtyre shërbimeve. Kur shërbimi ofrohet në bashkëpunim ndërmjet një sipërmarrësi të rrjeteve ose shërbimeve të komunikimeve elektronike dhe një ofruesi të përmbajtjes, aplikimi identifikon rolet e secilës palë dhe mbajtësin e propozuar të së drejtës. AKEP përcakton mbajtësin në vendimin e caktimit; marrëveshja ndërmjet palëve nuk kufizon përgjegjësinë e mbajtësit ndaj AKEP-it dhe përdoruesve fundorë.

4. Çdo përdorues, të cilit AKEP i ka caktuar drejtpërdrejtë një numër, është përgjegjës për të gjitha shërbimet e ofruara nëpërmjet këtij numri dhe çdo zgjatimi të tij.

5. Procesi i portabilitetit të numrit nga operatori dhënës tek operatori marrës rregullohet sipas rregullores për portabilitetin e numrit. Nëse pajtimtari i një numri që është caktuar sipas procesit të alokimit dytësor e bart këtë numër, alokimi parësor i numrave të tjerë në bllokun respektiv mbetet i pandryshuar, por numri i bartur do të trajtohet sikur ai të kishte qenë caktuar sipas procesit të alokimit parësor në operatorin marrës.

Neni 10
Aplikimi për caktimin e burimeve të numeracionit

1. Aplikimi për caktimin e burimeve numerike paraqitet nga operatorët e rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve publike si dhe sipërmarrjet e ndryshme nga këto të fundit, për kategorinë respektive të numrave sipas përcaktimeve në Planin Kombëtar të Numeracionit.

2. Aplikimet paraqiten online, nëpërmjet platformës elektronike e-aplikime publikuar në faqen zyrtare të AKEP. Në rastet e defekteve të sistemit elektronik, aplikimi dorëzohet në mënyrë shkresore pranë zyrës së protokoll-arkivit ose nëpërmjet postës elektronike në adresat e publikuara në faqen zyrtare të AKEP për këtë qëllim. AKEP shqyrton aplikimin dhe merr vendim për miratimin ose refuzimin e tij brenda një afati prej 3 (tri) javësh.

3. Aplikimi për burimet e numeracionit përmban të dhënat e mëposhtme:
   a. emrin, adresën e selisë dhe dokumentet në bazë të të cilave verifikohet regjistrimi i aktivitetit;
   b. të dhënat për llojin, sasinë dhe qëllimin e përdorimit të numrave të caktuar ose serive të numrave për të cilët është aplikuar;

c. planin e vlerësimit të nevojave për 3 vitet e ardhshëm, duke evidentuar nevojën e përllogaritur për numra të së njëjtës kategorie (për numra gjeografikë: në të njëjtën zonë gjeografike) dhe përqindja e përdorimit të numrave të së njëjtës kategorie (ose të njëjtës zone gjeografike) që kanë qenë caktuar më parë;
d. datën e planifikuar të fillimit të përdorimit të numrave ose serive të numrave;
e. aplikimi mund të përmbajë një preferencë për caktimin e një numri të caktuar ose një bllok numrash;
f. të dhëna shtesë, vetëm kur janë objektivisht të nevojshme dhe proporcionale për vlerësimin e kërkesës ose administrimin efikas të burimeve të numeracionit; kërkesa e AKEP, arsyetohet dhe përcakton afatin e përgjigjes.

4. Nëse aplikimi përmban të dhëna të pasakta ose të paplota, AKEP i kërkon aplikuesit të korrigjojë ose plotësojë të dhënat brenda 10 ditëve kalendarike.

5. AKEP refuzon caktimin e numrave ose blloqeve të numrave për të cilat është aplikuar, nëse:
   a. aplikimi për ndarjen e numrave përmban të dhëna të rreme;
   b. aplikanti nuk është i përshtatshëm për dhënien e numrave ose serive të numrave, në përputhje me këtë ligj;
   c. përdorimi i synuar nuk justifikon dhënien e sasisë ose llojin e numrave të kërkuar;
   d. aplikanti ka fatura të papaguara për përdorimin e burimeve të numeracionit;
   e. aplikanti ka keqpërdorur burimet e numeracionit në të kaluarën.

6. Sipërmarrësit kanë të drejtë të përcaktojnë numrat ose seritë e numrave për përdoruesit e tyre fundorë brenda numeracionit të caktuar nga AKEP.

7. Kur AKEP ka përcaktuar, pas konsultimit me palët e interesuara, se të drejtat e përdorimit për burimin e numeracionit me vlerë të jashtëzakonshme ekonomike jepen nëpërmjet procedurave konkurruese ose krahasuese të përzgjedhjes, atëherë afati maksimal i vlerësimit prej 3 javësh, të përmendur në pikën 2 të këtij neni, do të zgjatet deri në 3 javë të tjera.

8. Burimet e numeracionit të serive 1X, 5X, 7X, 8X dhe 9X, për të cilat e drejta e përdorimit caktohet drejtpërdrejt nga AKEP, implementohen nga operatorët e rrjeteve publike të komunikimeve elektronike brenda një afati jo më të gjatë se 3 (tri) javë nga data e marrjes së kërkesës së plotë, të shoqëruar me specifikimet teknike të nevojshme për realizimin e implementimit.

   8.1 Operatorët janë të detyruar të sigurojnë implementimin e këtyre burimeve në përputhje me parimet e transparencës, objektivitetit, proporcionalitetit dhe mosdiskriminimit, duke garantuar trajtim të barabartë për sipërmarrësit përfitues të të drejtave të përdorimit të numeracionit.
   8.2 Në rast mosmarrëveshjeje lidhur me plotësinë e dokumentacionit, kushtet teknike ose procedurat e implementimit, palët mund t'i drejtohen AKEP për zgjidhjen e mosmarrëveshjes, në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 54/2024. Paraqitja e mosmarrëveshjes nuk pezullon përmbushjen e detyrimeve dhe vijimin e procesit të

implementimit për elementet që nuk janë objekt kundërshtimi.

9. AKEP nuk e kufizon numrin e të drejtave individuale të përdorimit që do të jepen, me përjashtim të rasteve kur kjo është e nevojshme për të garantuar përdorimin efikas të burimeve të numeracionit.

Neni 11
Vlefshmëria e Autorizimit

10. Kohëzgjatja e së drejtës së përdorimit të burimeve të numeracionit përcaktohet në Autorizimin e lëshuar nga AKEP për caktimin dhe përdorimin e burimeve të numeracionit. Në rastet kur në Autorizin nuk përcaktohet një afat i caktuar vlefshmërie, e drejta e përdorimit konsiderohet e dhënë për një periudhë të pakufizuar, pa cenuar kompetencat e AKEP për ndryshimin, pezullimin ose revokimin e saj, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara në ligjin nr. 54/2024 dhe në këtë rregullore.

11. Çdo kufizim i kohëzgjatjes së së drejtës së përdorimit të burimeve të numeracionit, përfshirë burimet e serisë 19X, duhet të jetë objektivisht i justifikuar, proporcional dhe në përputhje me natyrën dhe karakteristikat e shërbimit përkatës. Kohëzgjatja e përcaktuar duhet të marrë në konsideratë objektivat e interesit të përgjithshëm, nevojën për administrimin efektiv të burimeve të numeracionit, si dhe sigurimin e një periudhe të përshtatshme për realizimin dhe amortizimin e investimeve, në përputhje me nenin 132 të ligjit nr. 54/2024.

12. Në rastet kur e drejta e përdorimit të burimeve të numeracionit është dhënë me afat të përcaktuar dhe mbajtësi i saj nuk paraqet kërkesë për vazhdimin e vlefshmërisë së kësaj të drejte, sipas afateve dhe procedurave të përcaktuara në këtë rregullore, e drejta e përdorimit përfundon me mbarimin e afatit të vlefshmërisë. AKEP mund të vendosë ricaktimin e këtyre burimeve një subjekti tjetër, pas kalimit të një periudhe prej të paktën 30 (tridhjetë) ditësh nga data e përfundimit të së drejtës së përdorimit, duke respektuar dispozitat ligjore dhe rregullatore në fuqi, si dhe kushtet për administrimin dhe përdorimin efektiv të burimeve të numeracionit.

Neni 12
Transferimi

1. Në rastin e transferimit të së drejtës së përdorimit të burimeve të numeracionit, kërkesa për transferim paraqitet bashkërisht pranë AKEP nga mbajtësi aktual i së drejtës së përdorimit (transferuesi) dhe subjekti që synon të përfitojë këtë të drejtë (përfituesi).

2. Transferuesi paraqet arsyet e transferimit, së bashku me dokumentacionin përkatës mbështetës, ndërsa përfituesi paraqet dokumentacionin që vërteton përmbushjen e kritereve dhe kushteve të zbatueshme për caktimin fillestar të së drejtës së përdorimit të burimeve përkatëse të numeracionit. Fakti që përfituesi nuk disponon të drejta të mëparshme përdorimi për burime të numeracionit nuk përbën, në vetvete, shkak për refuzimin e kërkesës për transferim.

3. Transferimi i së drejtës së përdorimit të burimeve të numeracionit kryhet vetëm pas miratimit paraprak nga AKEP. Në Autorizimin e AKEP përcaktohen data e hyrjes në fuqi të transferimit, kushtet dhe detyrimet që vijojnë të zbatohen për përfituesin, si dhe, sipas rastit, masat e nevojshme për garantimin e vazhdimësisë së ofrimit të shërbimeve dhe mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të përdoruesve fundorë. Transferimi i së drejtës së përdorimit të burimeve të numeracionit nuk cenon zbatimin e dispozitave ligjore dhe rregullatore në fuqi për portabilitetin e numrit.

Neni 13
Revokimi dhe pezullimi i caktimit të numrave

1. AKEP heq të drejtën e përdorimit të numrave dhe serive të numrave në rast se konstatohet se:
   a. mbajtësi i kërkesës për përdorimin e numrave ose serive të numrave nuk i plotëson kërkesat e përcaktuara në këtë rregullore, lidhur me caktimin e numrave dhe serive të numrave;
   b. zotëruesi i së drejtës së përdorimit të numrave dhe serive të numrave nuk ka paguar në kohë detyrimin vjetor për përdorimin e numrave dhe serive të numrave;
   c. mbajtësi i të drejtave për përdorimin e numrave dhe serive të numrave nuk ka filluar ende t'i përdorë ato brenda një periudhe 3-vjeçare nga data e caktimit të tyre;
   d. mbajtësi i të drejtave është çregjistruar ose ka pezulluar aktivitetin në Qendrën Kombëtare të Biznesit;
   e. me kërkesë të mbajtësit të së drejtës së përdorimit të numrave ose serive të numrave.

2. Për rastet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, AKEP, përpara se të heq të drejtën e përdorimit të numrave dhe serive të numrave, njofton me shkrim mbajtësin për faktet, bazën ligjore dhe masën e propozuar dhe i jep mundësi për të paraqitur vërejtje dhe masa korrigjuese.

3. Në rastet kur revokimi i së drejtës së përdorimit të burimeve të numeracionit propozohet për shkak të mospërmbushjes së detyrimeve financiare përkatëse, AKEP njofton mbajtësin e së drejtës së përdorimit dhe i cakton një afat jo më të shkurtër se 30 (tridhjetë) ditë nga data e marrjes së njoftimit për shlyerjen e detyrimeve të papaguara, përpara marrjes së vendimit për revokim.

4. Në rastet e tjera, të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, për revokimin e numrave dhe serive të numrave të caktuar, zbatimi i këtij vendimi nuk mund të jetë më i shkurtër se 60 ditë nga data e marrjes së njoftimit.

5. E njëjta procedurë, garanci dëgjimi dhe kërkesë proporcionaliteti zbatohet për të gjithë mbajtësit e të drejtave të përdorimit, përfshirë sipërmarrjet e ndryshme nga ofruesit e rrjeteve ose shërbimeve të komunikimeve elektronike.

6. AKEP mund të vendosë pezullimin e përkohshëm të dhënies së të drejtave të përdorimit

për kategori të caktuara të burimeve të numeracionit, për sipërmarrjet e ndryshme nga ofruesit e rrjeteve ose shërbimeve të komunikimeve elektronike, vetëm në rastet kur, në bazë të një vlerësimi të dokumentuar dhe të bërë publik, konstatohet një rrezik real i shterimit të burimeve përkatëse. Vendosja e kësaj mase duhet të jetë objektivisht e justifikuar, e nevojshme dhe proporcionale me rrezikun e identifikuar, duke përcaktuar qartë kategoritë e burimeve që preken, fushën e zbatimit dhe kohëzgjatjen e saj. Masa i nënshtrohet rishikimit periodik nga AKEP, me qëllim vlerësimin e vijimësisë së kushteve që kanë diktuar vendosjen e saj.

Neni 14
Detyrimet e mbajtësve të së drejtës së përdorimit të numrave

1. Mbajtësi i së drejtës së përdorimit të numrave:
   a. është i detyruar të kthejë numrat e caktuar ose seritë e numrave nëse nuk janë në përdorim;
   b. nuk mund të përdorë numrin e caktuar apo seritë e numrave, për qëllime të ndryshme nga ai për të cilat janë dhënë;
   c. nuk mund të transferojë ose të japë me qira numrat ose seritë e numrave të caktuara, pa miratimin paraprak të AKEP;
   d. numrat dhe seritë e numrave të caktuar mund të transferohen së bashku me aktivitetin e ushtruar kur mbajtësi i ri përmbush kërkesat për përdorimin e numrave dhe serive numerike, në përputhje me vendimin e AKEP-it;
   e. është i detyruar të bëjë pagesat për numeracionin;
   f. duhet të përmbushë kërkesën për transferimin e numeracionit në të gjitha rastet kur kërkohet një gjë e tillë;
   g. është i detyruar të përdorë numrat apo seritë e numrave të caktuara vetëm për qëllimin për të cilin i janë dhënë dhe të mos i shkaktojë dëm ndonjë grupi të caktuar përdoruesish;
   h. të përmbushë detyrimet që rrjedhin nga aktet ndërkombëtare, të zbatueshme në Republikën e Shqipërisë, për caktimin dhe përdorimin e numrave.

2. Shkeljet e dispozitave të kësaj rregulloreje përbëjnë kundërvajtje administrative dhe janë objekt i sanksioneve administrative vetëm në rastet dhe në masën e përcaktuar në nenin 184 të ligjit nr. 54/2024, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”.

Neni 15
Detyrimet e AKEP

1. AKEP në kuadër të harmonizimit, administrimit dhe përdorimit të numeracionit ka ndër të tjera këto detyrime:
   a. AKEP, për kategori të veçanta numrash, pas marrjes së mendimit nga ministri, mund të dakordësojë përdorimin e një plani të përbashkët numeracioni me shtetet anëtare të BE-së. Përdoruesit fundorë që preken informohen përkatësisht për këto rregullime.
   b. Në përputhje me detyrimet ndërkombëtare dhe për të siguruar burime të mjaftueshme numeracioni, AKEP, mund të ndryshojë strukturën, konfigurimin dhe caktimin e numrave, pasi të ketë zhvilluar konsultimin publik dhe të ketë përcaktuar masa e afate proporcionale tranzitore. Mbajtësi nuk ka të drejtë kompensimi për këto ndryshime.

AKEP, mund të ndryshojë vendimin e caktimit edhe me kërkesë të mbajtësit, kur kjo është e mundur. Përdoruesit fundorë të prekur informohen në kohë dhe në mënyrë të plotë.

c. AKEP-i mbështet harmonizimin e numrave ose serive të veçanta të numrave, ku ai promovon si funksionimin e tregut kombëtar, ashtu edhe zhvillimin e shërbimeve panevropiane.

2. AKEP siguron që përdoruesit fundorë si dhe ato me aftësi të kufizuar të kenë akses pa pagesë në një shërbim që operon një linjë telefonike për raportimin e rasteve të fëmijëve të humbur. Linja telefonike duhet të jetë e disponueshme në numrin "116000" si dhe sipas rastit "116111".

3. AKEP siguron, aty ku është e mundur ekonomikisht, përveç rasteve kur përdoruesi fundor i thirrur ka zgjedhur për arsye komerciale të kufizojë aksesin e palës thirrëse nga një zonë e veçantë gjeografike, që përdoruesit të jenë në gjendje:
   a) të aksesojnë të gjithë numrat e parashikuar në Planin Kombëtar të Numeracionit të Republikës së Shqipërisë;
   b) të aksesojnë të gjithë numrat, pavarësisht teknologjisë dhe pajisjeve të përdorura nga operatorët, duke përfshirë numrat sipas planeve të numeracionit të vendeve të tjera dhe numrat falas universalë ndërkombëtarë (UIFN).

4. AKEP, mund t'u kërkojë ofruesve të rrjeteve publike të komunikimeve elektronike ose shërbimeve të komunikimeve elektronike të disponueshme për publikun të bllokojnë, rast pas rasti, aksesin në numra ose shërbime, kur kjo justifikohet për arsye të mashtrimit ose keqpërdorimit. Në këtë rast, ofruesit e shërbimeve të komunikimeve elektronike mbajnë të ardhurat përkatëse nga interkoneksioni ose shërbimet e tjera.

Neni 16
Miratimi

1. Këshilli Drejtues i AKEP miraton: Planin Kombëtar të Numeracionit; kodin e drejtimit të rrjetit (NDC) për çdo operator të një rrjeti të lëvizshëm të komunikimeve publike, kodin kombëtar të destinacionit (NDC) për një zonë gjeografike të vendndodhjes fikse ose ndryshime të tij si dhe hapjen e një kategorie të re numrash.

2. Kategoritë e numrave dhe serive numerike që nuk përfshihen në pikën 1 të këtij neni, caktohen nga AKEP, sipas procedurës së përcaktuar në këtë rregullore mbi bazën e dokumentacionit të përgatitur nga strukturat përgjegjëse dhe miratohet nga titullari i Autoritetit.

Neni 17
Publikimi

1. AKEP administron dhe ruan të gjitha të dhënat dhe informacionet që lidhen me

administrimin dhe zbatimin e Planit Kombëtar të Numeracionit, përfshirë caktimin, përdorimin dhe statusin e burimeve të numeracionit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

2. AKEP publikon në faqen e tij zyrtare Planin Kombëtar të Numeracionit, si dhe çdo ndryshim ose shtesë të mëvonshme të tij, me përjashtim të informacionit që lidhet me burimet e numeracionit të përdorura për qëllime të sigurisë kombëtare, publikimi i të cilit kufizohet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

3. AKEP përditëson të dhënat e publikuara në faqen e tij zyrtare, sa herë që ndodhin ndryshime në administrimin dhe caktimin e burimeve të numeracionit. Të dhënat e publikuara përfshijnë informacion mbi blloqet e numeracionit dhe mbajtësit përkatës të të drejtave të përdorimit, duke respektuar kërkesat e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, konfidencialitetin e informacionit, sigurinë kombëtare dhe sigurinë e rrjeteve të komunikimeve elektronike.

Neni 18
Pagesat vjetore për caktimin e burimeve të numeracionit

1. Pagesat për caktimin dhe përdorimin e burimeve të numeracionit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

2. AKEP siguron që pagesat për të drejtat e përdorimit të burimeve të numeracionit të jenë objektivisht të justifikuara, transparente, jodiskriminuese dhe proporcionale me qëllimin për të cilin vendosen, duke marrë në konsideratë objektivat rregullatore të përcaktuara në ligjin nr. 54/2024, "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë".

3. Pagesa vjetore për të drejtat e përdorimit të numrave dhe serive të numrave kryhet paraprakisht, përpara fillimit të çdo periudhe vjetore të përdorimit, në përputhje me nenin 22, pika 4, të ligjit nr. 54/2024, "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë", dhe aktin përkatës në fuqi të Këshillit të Ministrave.

4. AKEP lëshon faturën përkatëse, në të cilën përcaktohen vlera e detyrimit financiar, periudha së cilës i referohet dhe afati për kryerjen e pagesës, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Afati i përcaktuar në faturë nuk ndryshon momentin e lindjes së detyrimit financiar, sipas përcaktimeve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

5. Në rast të mosshlyerjes së detyrimeve financiare për të drejtat e përdorimit të burimeve të numeracionit, zbatohen dispozitat e nenit 13 të kësaj rregulloreje.

KAPITULLI III
PLANI KOMBËTAR I NUMERACIONIT

Neni 19
Struktura e Planit Kombëtar të Numeracionit

1. Plani Kombëtar i Numeracionit është në përputhje me rekomandimin E.164 të ITU.

2. Numri ndërkombëtar përbëhet nga kodi shtetëror (Country Code-CC), i shoqëruar me numrin kombëtar (National Significant Number- N(S)N). Prefiksi ndërkombëtar "00" përdoret për thirrje ndërkombëtare nga Republika e Shqipërisë, i shoqëruar me kodin shtetëror të shtetit në të cilin drejtohet thirrja dhe numrin kombëtar. Kur operatori mbështet përdorimin e simbolit "+", kjo do të interpretohet si Prefiks Ndërkombëtar kur përdoret në fillim të thirrjes.

3. Kodi shtetëror i caktuar për Republikën e Shqipërisë është 355.

4. Numri kombëtar (NSN), përfshin kodin për thirrjen kombëtare (National Destination Code- NDC) dhe numrin e pajtimtarit (Subscriber Number- SN).

5. Struktura e skemës së planit të numeracionit është si më poshtë:

AB	**Qëllimi**
00 ose "+"	Kodi për prefiksin ndërkombëtar për thirrjet ndërkombëtare
0	Kodi për prefiksin kombëtar
10 X_1X_2	Prefikset për zgjedhjen e bartësit
99 X_1X_2	Kodet e rrugëzimit për portabilitetin e numrit
1X	Shërbimet e Emergjencës E-112, Numrat e shkurtër
2X-5X si dhe 8X	Seritë e numeracionit gjeografikë për telefoni fikse
5XXXX	Kodet e shkurtra për shërbimet e mesazheve me vlerë të shtuar (VAS-SMS)
6X	Seria e numeracionit jo gjeografik për telefoni të lëvizshme dhe MVNO
700X	Numrat personal/nomadë
751X	Seria e numeracionit jo gjeografik M2M/IoT
800X	Numrat e gjelbërt për shërbimet që thirren pa pagesë
801X	Numrat për kartat telefonike
808X	Numrat blu për shërbime që thirren me tarifa të ulëta pakice
900X	Numra për shërbime me vlerë të shtuar ku ofruesi merr një pjesë të pagesave me pakicë.

6. Thirrjet ndërkombëtare bëhen duke përdorur prefiksin ndërkombëtar 00, kodin kombëtar të caktuar nga ITU dhe numrin kombëtar.

7. Të gjithë numrat që nuk janë përfshirë në pikën 5 të këtij neni rezervohen për përdorim të ardhshëm dhe nuk duhet të përdoren në rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve publike.

Neni 20
Plani i numërformimit

1. Plani i numërformimit është një plan i mbyllur. Të gjithë operatorët që mbështesin thirrjet drejt rrjetit telefonik publik duhet të përdorin prefiksin e thirrjeve ndërkombëtare 00 për thirrjet ndërkombëtare. Nëse një numër kombëtar është thirrur duke formuar prefiksin e thirrjes ndërkombëtare 00 dhe kodin kombëtar shqiptar 355 operatorët do ta trajtojnë numrin e thirrur njëlloj sikur është thirrur prefiksi i thirrjes kombëtare 0 në vend të 00355. Për thirrjet hyrëse ndërkombëtare numri kombëtar formohet menjeherë pas kodit kombëtar shqiptar 355, pa formuar prefiksin kombëtar të thirrjes 0.

2. Të gjitha thirrjet në rrjetin kombëtar duhet të përdorin prefiksin kombëtar të thirrjes **0** para numrit të plotë kombëtar. Përjashtimet e këtij rregulli përshkruhen në pikën 3 dhe 4 të këtij neni.

3. Për thirrjet nga një numër gjeografik drejt një numri tjetër gjeografik, brenda ose jashtë të njëjtit rajon numeracioni, përdoruesi formon prefiksin kombëtar 0, kodin kombëtar të destinacionit (NDC) dhe numrin e pajtimtarit (SN).

4. Thirrjet drejt numrave të mëposhtëm që fillojnë me shifrën **1** nuk përdorin prefiksin kombëtar (**0**): numrat e urgjencës (**112, 125, 126, 127, 128, 129**), numrat për shërbimet e harmonizuara me interes social (**116**), numrat për shërbimet për marrjen e informacionit (**118**) dhe të gjithë kodet e shkurtër të harmonizuar europiane si dhe kodet e shkurtër për shërbimet e operatorit (**120-124, 13Y, 14Y, 165, 189Y**). Këto numra mund të thirren gjithashtu me prefiksin kombëtar **0** dhe kodin kombëtar të destinacionit (NDC) të një numri gjeografik. Në raste të tilla operatorët do të rrugëzojnë thirrjen sikur të origjinohej në një zonë gjeografike që i korrespondon kodit kombëtar të destinacionit (NDC).

5. Kodet e shkurtër për shërbimet (SMS) me vlerë të shtuar përdoren në rrjetet e lëvizshme pa prefiksin (0) ose një kod të drejtimit të rrjetit (6X ose 6XX).
6. Përdoruesit e shërbimeve të zgjedhjes së bartësit thërrasin:
   a) për thirrjet ndërkombëtare: prefiksin e përzgjedhjes së bartësit (**10XX**), prefiksin e thirrjes ndërkombëtare (**00**) dhe numrin ndërkombëtar;
   b) për thirrjet kombëtare: prefiksin për përzgjedhjen e bartësit (10XX), prefiksin e thirrjes kombëtare (0) dhe numrin e plotë kombëtar;

   Të gjithë operatorët që mbështesin ose ofrojnë shërbimin e zgjedhjen ose parazgjedhjes së bartësit duhet të mbështesin këto metoda thirrjeje.

7. Operatorët nuk do të diferencojnë tarifat e tyre të pakicës në bazë të metodës së përdorur për formimin e një numri.

Neni 21
Kodet e aksesit dhe kodet e shkurtër

1. Kodet e shkurtër janë me numër nga tre (3) deri në gjashtë (6) shifra, të cilat zakonisht fillojnë me 1, që i mundësojnë përdoruesit të ketë qasje në një seri të gjerë të shërbimeve telefonike.

2. Thirrjet në kodet 112, 116 $X_1X_2X_3$, 125-129 duhet të jenë pa pagesë pa marrë parasysh se nga cili rrjet origjinohet thirrja.
3. Kodet e shkurtër për shërbime emergjence dhe shërbime të tjera të harmonizuara në nivel evropian (HESC): 11X (ku: X=0-9) janë si më poshtë:

Domain	**Përshkrimi i shërbimit**	**Zona përdorimit**
110	Nuk është i disponueshëm për caktim (i rezervuar për zhvillime të ardhshme)	
111	Nuk është i disponueshëm për caktim (i rezervuar për zhvillime të ardhshme)	
112	Numri i vetëm i emergjencës	Kombëtare
113	Nuk është i disponueshëm për caktim (rezervuar për dërgimin e mesazheve drejt shërbimeve të emergjencës nga personat me aftësi të kufizuara në të folur dhe/ose dëgjim, të regjistruar në sistemin 112).	Kombëtare
114	Nuk është i disponueshëm për caktim (rezervuar si burim teknik për transmetimin e mesazheve drejt shërbimeve të emergjencës).	Kombëtare
115	Nuk është i disponueshëm për caktim (i rezervuar për zhvillime të ardhshme)	
$116X_1X_2X_3$	Numra kombëtarë për shërbime të harmonizuara me interes social	Kombëtare
117	Nuk është i disponueshëm për caktim (i rezervuar për zhvillime të ardhshme)	
$118X_1X_2$	Numra kombëtarë për shërbimin e informacionit	Kombëtare
119	Nuk është i disponueshëm për caktim (i rezervuar për zhvillime të ardhshme).	Kombëtare

4. Kodet e shkurtër për shërbime me vlerë të shtuar, shërbime rrjeti, shërbime urgjence si dhe për shërbime me interes publik janë si më poshtë:

Domain	**Përshkrimi i shërbimit**	**Zona përdorimit**
12 (NDC)	Shërbime me vlerë të shtuar, shërbime të operatorit të rrjetit dhe shërbimet e urgjencës	Kombëtare
	120-124- kode të shkurtër për shërbime të operatorit	
	125- thirrje ndaj QNOD- emergjencat në det	
	126- thirrje ndaj policisë së trafikut	
	127- thirrje për urgjencat mjekësore	
	128- thirrje për zjarrëfikëse	
	129- thirrje për policinë e krimeve	
13 (NDC)	Shërbime të operatorit të rrjetit	Kombëtare
14 (NDC)	Shërbime të operatorit të rrjetit	Kombëtare
15 (NDC)	Shërbime me vlerë të shtuar, shërbime të operatorit të rrjetit	Kombëtare
16 (NDC)	Shërbime me vlerë të shtuar, shërbime të operatorit të rrjetit	Kombëtare
	165- shërbime të operatorit të rrjetit	
17	Rezervuar për përdorim për funksione të rrjetit*	
18 (NDC)	Shërbime me vlerë të shtuar, shërbime të operatorit të rrjetit	Kombëtare
	189- shërbime të operatorit të rrjetit	
19 (NDC)	Shërbime me interes publik në nivel kombëtar**	Kombëtare

** Mund të përdoren gjithashtu si numër i shkurtër kombëtarë të brendshëm për ofrimin e shërbimeve specifike të rrjetit ose për ofrimin e shërbimeve me vlerë të shtuar, vetëm nëse ky përdorim nuk pengon përdorimin e tyre si funksione të rrjetit (si testime, sinjalizime, shërbime emergjente ose funksione operacionale të operatorit).*

***Për përdorimin e këtij numri të shkurtër, subjekti i interesuar duhet të paraqesë kërkesë me shkrim pranë AKEP ku të evidentohet emri i shërbimit, pse konsiderohet shërbim me interes publik kombëtar, cfarë informacioni do të mundësojë për qytetarin. Gjithashtu duhet të provohet kompetenca ligjore që i jep përgjegjësi në atë fushë. Nëse aplikimin në AKEP e bën sipërmarrësi i komunikimeve elektronike por shërbimin do ta ofrojë një subjekt tjetër, atëherë me aplikimin duhet të paraqitet edhe një marrëveshje ndërmjet sipërmarrësit dhe subjektit që do të ofrojë shërbimin, kjo me qëllim që të evidentohet pala përgjegjëse për shërbimin që do të ofrohet përmes atij numri.*

Neni 22
Numri i emergjencës 112

1. Sipërmarrësit duhet të sigurojnë që të gjithë përdoruesit fundorë, përfshirë përdoruesit e telefonave publikë me pagesë të kenë akses në shërbimet e emergjencës nëpërmjet komunikimeve të emergjencës pa pagesë dhe pa pasur nevojë të përdorin asnjë mjet pagese, duke përdorur numrin unik evropian të emergjencave "112" dhe çdo numër kombëtar të emergjencës, të përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi.

2. AKEP-i promovon aksesin në shërbimet e emergjencës nëpërmjet numrit unik evropian të emergjencave "112" nga rrjetet e komunikimeve elektronike, që nuk janë publike, por e mundësojnë thirrjen drejt rrjeteve publike të komunikimit elektronik, veçanërisht kur sipërmarrësi përgjegjës për atë rrjet nuk ofron akses alternativ dhe të lehtë për shërbimet e emergjencës.

3. AKEP-i, pas konsultimit me autoritetet përgjegjëse për shërbimet e emergjencës dhe ofruesit e shërbimeve të komunikimeve elektronike siguron që ofruesit e shërbimeve të komunikimeve ndërpersonale, të bazuara në numra të disponueshëm për publikun, që u mundësojnë përdoruesve fundorë origjinimin e thirrjeve drejt numrave të planit kombëtar ose ndërkombëtar të numeracionit, që të sigurojnë akses në shërbimet e emergjencës nëpërmjet komunikimeve të emergjencës drejt PSAP-ve më të përshtatshme, sipas pikës 3 të nenit 47 të ligjit nr. 45/2019, "Për mbrojtjen civile".

4. Autoritetet kompetente të PSAP-ve sigurojnë që të gjitha komunikimet e emergjencës drejt numrit unik evropian të emergjencës "112" të përgjigjen dhe të trajtohen në mënyrën më të përshtatshme për organizimin kombëtar të sistemeve të emergjencës. Këto komunikime të emergjencës drejt numrit "112" duhet të përgjigjen dhe të trajtohen me të paktën të njëjtin nivel shpejtësie dhe efektiviteti sa edhe komunikimet drejt numrave kombëtarë të emergjencës, për sa kohë ato vazhdojnë të jenë në përdorim.

5. Autoritetet kompetente të PSAP-ve do të marrin në konsideratë raportet e Komisionit Evropian për efektivitetin e zbatimit të numrit unik evropian të emergjencës "112" .

6. AKEP, në bashkëpunim me autoritetet e PSAP-ve, siguron që aksesi i përdoruesve fundorë me aftësi të kufizuara në shërbimet e emergjencës të jetë i disponueshëm nëpërmjet komunikimeve të emergjencës dhe të jetë i barasvlershëm me atë që gëzojnë përdoruesit e tjerë fundorë, në përputhje me legjislacionin dhe rregullat në fuqi në Republikën e Shqipërisë, për kërkesat e aksesueshmërisë për produktet dhe shërbimet. AKEP merr masat e duhura për të siguruar që gjatë udhëtimit në një shtet tjetër përdoruesit fundorë me aftësi të kufizuara të kenë akses në shërbimet e emergjencës, në mënyrë të barasvlershme me

përdoruesit e tjerë fundorë, kur është e mundur, pa pasur nevojë për ndonjë regjistrim paraprak.

7. Ofruesit e komunikimeve ndërpersonale të bazuara në numra duhet të sigurojnë që informacioni i vendndodhjes së palës thirrëse të vihet në dispozicion të PSAP-së më të përshtatshme, pa vonesë, pas vendosjes së komunikimit emergjent. Kjo do të përfshijë informacionin e vendndodhjes së bazuar në rrjet, dhe, kur është i disponueshëm, informacionin e vendndodhjes së palës thirrëse të gjeneruar nga aparati fundor i lëvizshëm. Ofruesit duhet të sigurojnë që krijimi dhe transmetimi i informacionit të vendndodhjes së palës thirrëse të jetë pa pagesë për përdoruesin fundor dhe PSAP-të për të gjitha komunikimet e emergjencës me numrin unik evropian të emergjencës "112". AKEP mund ta zgjerojë fushën e veprimit të këtij detyrimi për të përfshirë edhe komunikimet e emergjencës drejt numrave kombëtarë të emergjencës. Kriteret për t'u zbatuar për saktësinë dhe besueshmërinë e informacionit të dhënë për vendndodhjen e palës thirrëse përcaktohen nga AKEP.

8. Ofruesit duhet të sigurojnë që përdoruesit fundorë të jenë të informuar në mënyrë të përshtatshme dhe të duhur për ekzistencën dhe përdorimin e numrit unik evropian të emergjencës "112", si dhe funksionet e aksesueshmërisë së tij, përfshirë nëpërmjet iniciativave që synojnë veçanërisht përdoruesit fundorë me aftësi të kufizuara. Ky informacion do të jepet në formate të aksesueshme, duke adresuar lloje të ndryshme të aftësive të kufizuara.

9. Për të siguruar akses efektiv në shërbimet e emergjencës nëpërmjet komunikimeve të emergjencës me numrin unik evropian të emergjencës "112", AKEP miraton rregullat e nevojshme për të garantuar përputhshmërinë, ndërveprueshmërinë, cilësinë, besueshmërinë dhe vijueshmërinë e komunikimeve të emergjencës në shtetet anëtare evropiane, në lidhje me zgjidhjet për informacionin për vendndodhjen e palës thirrëse, aksesin për përdoruesit fundorë me aftësi të kufizuara dhe rrugëzimin e komunikimeve drejt PSAP-ve më të përshtatshme. Këto rregulla duhet të miratohen pa prekur dhe pa ndikuar organizimin e shërbimeve të emergjencës, të cilët mbeten në kompetencën ekskluzive të Republikës së Shqipërisë.

Neni 23
Numrat e harmonizuar për shërbimet sociale 116 $X_1X_2X_3$

1. Numrat e harmonizuar për shërbimet sociale të interesit publik $116X_1X_2X_3$ caktohen për përdorim në përputhje me vendimet e Komisionit Evropian për këtë qëllim. Konkretisht:

Numri	**Shërbimi për të cilin është rezervuar ky numër**	**Kushtet e veçanta që shoqërojnë të drejtën e përdorimit të këtij numri**
116 000	**Emri i shërbimit:** Linja telefonike e ndihmës për fëmijët e zhdukur. **Përshkrimi:** Shërbimi:	Shërbimi duhet të jetë i aksesueshëm pa ndërprerje, 24/7, në nivel kombëtar.

	a) pranon telefonata për raportimin e fëmijëve të zhdukur dhe ia përcjell informacionin Policisë; b) ofron këshillim, orientim dhe mbështetje për personat përgjegjës për fëmijën e zhdukur; c) mbështet procesin e kërkimit dhe hetimit për gjetjen e fëmijës.	
116 006	**Emri i shërbimit:** Linja e ndihmës për viktimat e krimit. **Përshkrimi:** Shërbimi u mundëson viktimave të krimit të marrin mbështetje emocionale, të informohen mbi të drejtat e tyre dhe mënyrat për t'i ushtruar ato, si dhe të orientohen drejt organizatave përkatëse. **Në veçanti,** shërbimi ofron informacion lidhur me: a) policinë vendore dhe procedurat e drejtësisë penale; b) mundësitë për kompensim dhe çështjet e sigurimeve. Gjithashtu, shërbimi ofron mbështetje për gjetjen e burimeve të tjera të ndihmës që janë të përshtatshme për viktimat e krimit.	Kur shërbimi nuk ofrohet në mënyrë të vazhdueshme (24/7, në nivel kombëtar), ofruesi i shërbimit duhet të sigurojë që informacioni mbi disponueshmërinë e shërbimit të jetë publikisht i aksesueshëm në një formë lehtësisht të arritshme. Gjithashtu, gjatë periudhave kur shërbimi nuk është i disponueshëm, personat që telefonojnë duhet të informohen se kur shërbimi do të jetë sërish i disponueshëm.
116 016	**Emri i shërbimit:** Linja e ndihmës për viktimat e dhunës ndaj grave. **Përshkrimi:** Shërbimi u mundëson viktimave të dhunës ndaj grave të kërkojnë ndihmë dhe mbështetje, të informohen mbi të drejtat e tyre dhe mënyrat për t'i ushtruar ato, si dhe të orientohen drejt organizatave përkatëse.	Kur shërbimi nuk ofrohet në mënyrë të vazhdueshme (24/7, në nivel kombëtar), ofruesi i shërbimit duhet të sigurojë që informacioni mbi disponueshmërinë e shërbimit të jetë publikisht i aksesueshëm në një formë lehtësisht të arritshme. Gjithashtu, gjatë periudhave kur shërbimi nuk është i disponueshëm, personat që telefonojnë duhet të informohen se kur shërbimi do të jetë sërish i disponueshëm.
116 111	**Emri i shërbimit:** Linja e ndihmës për fëmijët. **Përshkrimi:** Shërbimi u ofron ndihmë fëmijëve që kanë nevojë për kujdes dhe mbrojtje, si dhe i orienton ata drejt shërbimeve dhe burimeve përkatëse. Ai u jep fëmijëve mundësinë të shprehin shqetësimet e tyre, të diskutojnë çështje që i prekin drejtpërdrejt dhe të kontaktojnë me një person të gatshëm për t'i ndihmuar në situata emergjente.	Kur shërbimi nuk ofrohet në mënyrë të vazhdueshme (d.m.th. 24/7, në nivel kombëtar), ofruesi i shërbimit duhet të sigurojë që informacioni mbi disponueshmërinë e tij të jetë i publikuar dhe lehtësisht i aksesueshëm për publikun. Gjithashtu, gjatë periudhave kur shërbimi nuk është i disponueshëm, telefonuesit duhet të informohen se kur shërbimi do të jetë sërish i disponueshëm.
116 117	**Emri i shërbimit:** Shërbimi mjekësor në gatishmëri për raste jo emergjente. **Përshkrimi:** Shërbimi i drejton telefonuesit drejt ndihmës mjekësore të përshtatshme për nevojat e tyre, të cilat janë urgjente por jo kërcënuese për	Kur shërbimi nuk ofrohet në mënyrë të vazhdueshme (d.m.th. 24/7, në nivel kombëtar), ofruesi i shërbimit duhet të sigurojë që informacioni mbi disponueshmërinë e tij të jetë i publikuar dhe lehtësisht i aksesueshëm për publikun.

	jetën, veçanërisht jashtë orarit normal të punës, gjatë fundjavave dhe festave zyrtare. Ai e lidh telefonuesin me një operator të trajnuar dhe të mbështetur, ose drejtpërdrejt me një mjek apo profesionist shëndetësor të kualifikuar.	Gjithashtu, gjatë periudhave kur shërbimi nuk është i disponueshëm, telefonuesit duhet të informohen se kur shërbimi do të jetë sërish i disponueshëm.
116 123	**Emri i shërbimit:** Linjat e ndihmës për mbështetje emocionale. **Përshkrimi:** Shërbimi i mundëson telefonuesit të përfitojë nga një marrëdhënie njerëzore e vërtetë, e bazuar në dëgjim pa gjykim. Ai ofron mbështetje emocionale për telefonuesit që vuajnë nga vetmia, ndodhen në krizë psikologjike ose po mendojnë për vetëvrasje.	Kur shërbimi nuk ofrohet në mënyrë të vazhdueshme (d.m.th. 24/7, në nivel kombëtar), ofruesi i shërbimit duhet të sigurojë që informacioni mbi disponueshmërinë e tij të jetë i publikuar dhe lehtësisht i aksesueshëm për publikun. Gjithashtu, gjatë periudhave kur shërbimi nuk është i disponueshëm, telefonuesit duhet të informohen se kur shërbimi do të jetë sërish i disponueshëm.

2. Duke qenë se numrat **116$X_1X_2X_3$** janë të kufizuar, e drejta e caktimit dhe përdorimit të tyre do t'i jepet aplikuesit që e ka fituar këtë të drejtë. Bazuar në disponueshmëri, AKEP publikon në faqen zyrtare të internetit www.akep.al njoftimin mbi ndarjen dhe përdorimin e numrave të shkurtër kombëtar për shërbimet e harmonizuara në nivel evropian.

   Ky njoftim përcakton shërbimin social të harmonizuar që mund të ofrohet nëpërmjet numrit përkatës, karakteristikat e këtij shërbimi, datën kur duhet të dorëzohet aplikimi, dokumentacioni shoqërues si dhe pikëzimin në lidhje me kriteret për vlerësimin e këtij numri kombëtar. Shtojca 4, parashikon procedurën për caktimin e numrave të shkurtër kombëtar për shërbimet sociale të harmonizuara të disponueshëm për pëdorim.

3. AKEP revokon caktimin e numrit dhe do të zhvillojë një proçedurë të re, nëse nuk sigurohet përdorimi i tij sipas qëllimit të dhënë dhe ofrimi i shërbimit me cilësinë e kërkuar. Për rastin e revokimit ndiqet procedura e sqaruar në nenin 13 të kësaj rregulloreje.

Neni 24
Numrat e shërbimit të informacionit telefonik 118X_1X_2

Numrat **118X_1X_2** janë të dedikuar ekskluzivisht për shërbimet e informacionit telefonik, që u mundësojnë përdoruesve marrjen e informacionit mbi numrat e abonentëve të shërbimeve publike telefonike. Për tarifimin me pakicë zbatohen të njëjtat rregulla si për shërbimet me vlerë të shtuar. Ofrimi i çdo shërbimi tjetër me vlerë të shtuar përmes këtyre numrave është i ndaluar.

Neni 25
Numrat e shkurtër për shërbimet e operatorit të rrjetit

1. Numrat e shkurtër për shërbimet e operatorit të rrjetit janë përcaktuar për shërbimet që janë të lidhura drejtpërdrejt me ofrimin e një shërbimi publik të telefonisë, si kujdesi për klientin, ndihma për klientin, hapja-mbyllja e kodit nga terminalet jo-multifrekuencë,

trajtimi i ankesave, pyetje për faturat, ngarkimi i kreditit të parapaguar, pyetje për kreditin e parapaguar ose pajtimi në shërbime/cilësi shtesë.

2. Numrat e shkurtër për shërbimet e operatorit nuk mund të përdoren për të ofruar shërbime me vlerë të shtuar ose shërbime të tjera që nuk kanë lidhje të drejtpërdrejtë me ofrimin e shërbimit të telefonisë publike. Tarifa me pakicë për thirrjen drejt një numri të shkurtër për shërbimet e operatorit nuk duhet të jetë më e lartë se sa niveli më i lartë në tarifën përkatëse me pakicë të operatorit për thirrjen drejt numrave gjeografikë.

3. Numrat e shkurtër për shërbimet e operatorit kanë si qëllim vetëm përdorimin brenda rrjetit përkatës telefonik dhe nuk përdoren në interkoneksionin ndërmjet rrjeteve.

4. Numrat e shkurtër për shërbimet e operatorit kanë formatin me tri shifra.

5. Të gjithë operatorët e rrjeteve të telefonisë publike ose të shërbimeve të telefonisë publike mund të përdorin numrin e shkurtër **123** për mirëmbajtje pa kërkuar caktimin e këtij numri nga AKEP. Operatorët mund të shtojnë shifra shtesë pas **123** në varësi të vendndodhjes ose tipit të defektit.

6. Të gjithë operatorët e rrjeteve ose të shërbimeve të telefonisë publike mund të përdorin numrin **165** për shërbimin "Thirrje telefonike me tarifë të reduktuar për pajtimtarë të rrjetit të vet që bëjnë pjesë në grupe të vegjël të veçanta të tregut".

7. Operatorët mund të përdorin kode të shkurtra në formatet 13X ose 14X vetëm brenda rrjetit të tyre, pasi të kenë njoftuar AKEP-in për kodin dhe shërbimin përkatës. Ky përdorim nuk përbën caktim, nuk krijon të drejtë ekskluzive dhe mund të kufizohet ose tërhiqet nga AKEP-i për të shmangur konfliktin me Planin Kombëtar të Numeracionit ose për të mbrojtur përdoruesit.

8. Numrat e tjerë, si 15 (NDC), 17 si dhe numrat e pa alokuar në kategoritë 13(NDC) dhe 14(NDC), do të caktohen sipas shërbimit të përcaktuar në pikën 4 të nenit 21, të kësaj rregulloreje.

Neni 26
Numrat gjeografikë

1. Numrat gjeografikë janë përcaktuar për t'u përdorur në një vendndodhje fikse, pra në rrjetet e qendrueshëm (fiks) publike të komunikimeve. Një numër gjeografik përbëhet nga kodi i destinacionit kombëtar (NDC) dhe numëri i pajtimtarit (SN).

2. Kodi kombëtar i destinacionit i korrespondon zonës gjeografike të vendndodhjes fikse. Shtojca 1 e kësaj rregulloreje specifikon se cili kod kombëtar destinacioni përdoret për secilën zonë gjeografike. Kodet kombëtare të destinacionit kanë 1 (një) deri në 3 (tri) shifra dhe fillojnë me 2, 3, 4, 5 ose 8.

3. Numrat e pajtimtarëve kanë 5 (pesë) deri në 7 (shtatë) shifra dhe fillojnë me cfarëdolloj shifre përveç shifrave 0 dhe 1. Gjatësia e përgjithshme e një numri gjeografik (duke

përfshirë kodin kombëtar të destinacionit dhe numrin e pajtimtarit) është 8 shifra.

4. AKEP, në procesin e alokimit parësor u cakton numra gjeografik operatorëve të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve publike në blloqe prej 1.000 ose 10.000 numrash.

5. Operatorët, në procesin e alokimit dytësor caktojnë numra gjeografikë individualë për përdorim në një vendndodhje fikse. Një operator mund t'i caktojë një numër gjeografik një pajtimtari nëse:
   a) numri gjeografik përdoret në një pikë fundore fikse të rrjetit, e cila ndodhet në një zonë gjeografike që i korrespondon kodit të destinacionit kombëtar të numrit gjeografik, ose
   b) numri gjeografik përdoret në një zone të vogël të rrjetit të komunikimeve të lëvizshme, e cila kufizon hapesiren rrethuese të një adresë qe ndodhet në zonën gjeografike te ciles i korrespondon kodi i destinacionit kombëtar të numrit gjeografik (shërbimi i lëvizshëm-zona e shtëpisë-"home zone");
   c) operatori verifikon që adresa e pajtimtarit është brenda zonës gjeografike që i korrespondon kodit kombëtar të destinacionit. Verifikimi kryhet me dokumentacionin minimal të nevojshëm; për personin juridik përdoret dokumenti i regjistrimit i lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit.

6. Operatorët, në procesin e alokimit dytësor mund të caktojnë numra individualë gjeografikë që janë më të shkurtër se ato të parashikuar në planin e numeracionit sipas kushteve të mëposhtme:
   a) numrat gjeografikë mund të shkurtohen vetëm me një shifër, nëse pajtimtari përdor numrin për të lidhur të paktën pesë pajisje të përdoruesve fundorë sipas zgjatimeve të këtij numri.
   b) numrat gjeografikë mund të shkurtohen me dy shifra nëse pajtimtari përdor numrin për të lidhur të paktën 50 pajisje të përdoruesve fundorë sipas zgjatimeve të këtij numri.
   c) numrat gjeografikë mund të shkurtohen me tri shifra nëse pajtimtari përdor numrin për të lidhur të paktën 500 pajisje të përdoruesve fundorë sipas zgjatimeve të këtij numri.

7. Një numër gjeografik mund të përdoret përkohësisht në një vend jashtë zonës gjeografike që i korrespondon kodit të destinacionit kombëtar të numrit gjeografik (përdorimi nomadik). Operatorët që mundësojnë përdorimin nomadik, duhet të informojnë pajtimtarët për përfitimet dhe rreziqet e përdorimit nomadik, në vecanti në lidhje me shërbimet e thirrjeve të urgjencës. Në lidhje me tarifat e pakicës dhe interkoneksionit supozohet se një numër gjeografik përdoret kryesisht në vendndodhjen e vet fikse dhe që kostot shtesë të përdorimit nomadik paguhen nga pajtimtari dhe jo nga përdoruesi që thërret numrin gjeografik.

Neni 27
Numra jogjeografikë për shërbime të komunikimeve elektronike që ofrohen në vendndodhje të lëvizshme

1. Kjo kategori numrash është përcaktuar për t'u përdorur në një rrjet të lëvizshëm të komunikimeve elektronike publike. Një numër i lëvizshëm përbëhet nga prefiksi i numrave

të lëvizshëm dhe një numër pajtimi.

2. Kodi i drejtimit të rrjetit ka dy ose tre shifra dhe fillon me 6 (gjashtë). Gjatësia e përgjithshme e numrave të lëvizshëm (Kodi i drejtimit të rrjetit dhe numri i pajtimtarit) është 9 (nëntë) shifra.

3. AKEP, në procesin e alokimit parësor (primary alocation), u cakton numra të lëvizshëm operatorëve të rrjeteve ose shërbimeve të komunikimeve elektronike në blloqe prej 1.000 ose 10.000 numrash. Operatorët, në procesin e alokimit dytësor (secondary alocation) u caktojnë numra individualë pajtimtarëve.

4. AKEP-i rezervon ose cakton kode drejtimi dhe blloqe numrash të lëvizshëm vetëm mbi bazën e nevojës së dokumentuar, përdorimit aktual, parashikimit trevjeçar, kërkesave objektive të rrugëzimit dhe përdorimit efikas të burimeve. Rezervimi nuk krijon të drejtë automatike ose ekskluzive mbi të gjithë diapazonin. Çdo caktim bëhet në bllokun më të vogël të përshtatshëm dhe me të njëjtat kritere, pavarësisht modelit të biznesit, teknologjisë ose pozitës në treg të aplikantit. Caktimet ekzistuese vijojnë sipas dispozitave kalimtare, pa krijuar përparësi për caktime të reja.

Neni 28
Numrat jo gjeografik për ofruesit MVNO

1. Operatorët e rrjetit virtual celular (MVNO), të autorizuar për ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike në vendndodhje të lëvizshme dhe që nuk zotërojnë të drejta përdorimi për frekuenca radio, mund të pajisen nga AKEP me numra jo-gjeografikë nga seritë 60 $X_1X_2X_3X_4X_5X_6X_7$- 61 $X_1X_2X_3X_4X_5X_6X_7$, sipas kushteve të përcaktuara në këtë rregullore.

2. AKEP, në procesin e alokimit parësor (primary allocation), u cakton operatorëve MVNO blloqe numerike prej 1.000 ose 10.000 numrash. Operatorët MVNO, në procesin e alokimit dytësor (secondary allocation), u caktojnë numra individualë pajtimtarëve të tyre.

3. MVNO që disponon elemente bazë të rrjetit të vet (Full MVNO), përfshirë HLR (*Home Location Register*), MSC (*Mobile Switching Centre*), SMSC/MMSC (*SMS and MMS Switching Centre(s)*), SGSN/GGSN (*Mobile Data network elements*), paraqet në aplikim informacion mbi këto elemente dhe strukturën e përdorimit të blloqeve të numeracionit. Këta operatorë mund të pajisen me kod të veçantë të drejtimit të rrjetit (NDC), sipas pikës 1 të këtij neni.

4. MVNO-ja që nuk provon kontrollin funksional sipas pikës 3 përdor, si rregull, kodin e operatorit pritës sipas marrëveshjes ndërmjet palëve. Operatori pritës nuk mund të refuzojë ose vonojë pa arsye objektive implementimin e burimeve dhe zbaton kushte transparente e jodiskriminuese. Kjo pikë nuk pengon një aplikim të mëvonshëm të MVNO-së kur plotësohen kriteret funksionale.

Neni 29
Numra jogjeografikë për shërbime të komunikimeve elektronike, të ndryshme nga shërbimet e komunikimeve ndërpersonale

1. Kjo kategori është përcaktuar për shërbime/aplikacione si komunikimet Makinë me Makinë (*M2M- Machine-to-Machine*) dhe Interneti i Gjërave (*IoT-Internet of Things*).


2. Shërbimet M2M/IoT mund të ofrohen nga MNO-të, MVNO-të, ofruesit e shërbimeve M2M/IoT dhe sipërmarrje të tjera që plotësojnë kërkesat e ligjit nr. 54/2024, të kësaj rregulloreje dhe të Udhëzimeve BEREC BoR (20) 50 për administrimin e burimeve të numeracionit.

3. Shërbimet M2M/IoT mund të përdorin:
   a) burimet ekzistuese të numeracionit të alokuara operatorëve celular.
   b) blloqe të dedikuara numerike të përcaktuara nga Autoriteti për këto shërbime.

4. Përdorimi i burimeve ekzistuese të numeracionit në rrjetet celulare nuk kufizon të drejtën e sipërmarrësve për të ofruar shërbime M2M/IoT mbi blloqe të tjera numerike të alokuara posaçërisht për këtë qëllim.

5. Kodi identifikimit i përcaktuar për numra jo-gjeografik të përdorur në rrjete publike fikse dhe të lëvizshme për nevoja të shërbimeve të komunikimit M2M do të jetë 751.

6. Numri i pajtimtarit për shërbimet M2M/IoT është 12 shifra i gjatë dhe përbëhet nga kodi identifikimit 751. Seria numerike për këtë shërbim do të jetë 751 $X_1X_2X_3X_4X_5X_6X_7X_8X_9$.



CC Country code for IoT/M2M services/applications
IoTIC IoT identification code
IoTSN IoT subscriber number

7. Blloqet caktohen në kapacitete prej 10.000, 100.000, 1.000.000 ose 10.000.000 numrash, sipas nënndarjeve të Planit Kombëtar të Numeracionit. AKEP-i cakton bllokun më të vogël që mbulon nevojën e arsyetuar trevjeçare, duke marrë parasysh nivelin e përdorimit të burimeve ekzistuese, planin e aktivizimit dhe rrezikun e shterimit. Një bllok shtesë caktohet vetëm kur përdorimi dhe parashikimi justifikojnë objektivisht kapacitetin e kërkuar.

8. Numrat për shërbimin M2M mund të njoftohen për përdorim jashterritorial në shtetet e Bashkimit Evropian (BE), sipas procedurave të përcaktuara në rekomandimet e ITU E.164 dhe E.212. Në këtë rast në Autorizim do të përcaktohet qartë diapazoni i numrave M2M jashtë juridiksionit të Republikës së Shqipërisë. Numrat M2M të përdorur jashtë territorit do të duhet të jenë në përputhje me legjislacionin dhe rregullat e mbrojtjes së konsumatorit në vendin ku operojnë.

Neni 30
Numrat personal/ nomadë (700$X_1X_2X_3X_4X_5$)

1. Numrat personalë janë krijuar për përdorim në cdo vendndodhje fikse ose për përdorim nomadik.

2. Në lidhje me tarifat me pakicë dhe të interkoneksionit, numrat personalë duhet të trajtohen si numra gjeografikë me përjashtimin që numri personal nuk përmban një kod kombëtar destinacioni që do të tregonte vendndodhjen e pajtimtarit. Tarifa me pakicë për thirrjet në numrat personalë nuk duhet të jetë më e lartë se sa niveli më i lartë në tarifën me pakicë të operatorit respektiv për thirrjet ndaj numrave gjeografikë.

3. Numrat personalë përbëhen nga prefiksi **700** dhe numri i pajtimtarit me 5 (pesë) shifra. Gjatësia e përgjithshme e numrit është 8 (tetë) shifra.

4. AKEP, në procesin e alokimit parësor (primary alocation), u cakton numra personalë operatorëve të rrjeteve ose shërbimeve të komunikimeve elektronike në blloqe prej 1.000 ose 10.000 numrash.

5. Operatorët, në procesin e alokimit dytësor (scondary alocation), caktojnë numra personalë individualë për pajtimtarët.

Neni 31
Numrat e gjelbërt (800$X_1X_2X_3X_4$)

Numrat e gjelbër janë përcaktuar për shërbimet që mund të thirren pa pagesë. Ato përbëhen nga prefiksi **800** dhe një numër me 4 (katër) shifra. Gjatësia e përgjithshme e një numri të gjelbër është shtatë shifra. Tarifa me pakicës për thirrjet drejtuar numrave të gjelbër duhet të jetë zero. AKEP cakton drejtpërdrejt numra të gjelbër për ofruesit e shërbimeve të numrave të gjelbër.

Neni 32
Numrat për kartat telefonike (801$X_1X_2X_3$)

1. Numrat për kartat telefonike janë përcaktuar për thirrjen drejt shërbimit të kartave telefonike. Ato nuk duhet të përdoren për shërbime të tjera përveç thirrjes në një kartë telefonike, në veçanti jo për shërbimet me vlerë të shtuar. Numrat për kartat telefonike përbëhen nga kodi i aksesit 801 dhe 3 (tri) shifra.

2. Ofruesit e shërbimeve të kartave telefonike duhet të informojnë pajtimtarët e tyre për pagesat që duhet ti bëjnë operatorit të shërbimit telefonik, në veçanti, kur telefonohet nga një telefon publik me pagesë dhe cilat pagesa duhet ti japin ofruesit të shërbimit të kartave telefonike. Ky informacion duhet të përfshijë informacion për momentin kur fillon tarifimi dhe kur përfundon dhe në çfarë mase duhet paguar për telefonatat e pasuksesshme.

3. AKEP cakton këto numra drejtpërdrejtë për ofruesit e shërbimeve të kartave telefonike.

Neni 33
Numrat blu (808$X_1X_2X_3$)

Numrat blu janë krijuar për shërbime që mund të thirren me tarifa të ulëta pakice. Ato përbëhen nga kodi i aksesit 808 dhe një numër pajtimtari me 3 (tri) shifra. Gjatësia e përgjithshme e një numri blu është gjashtë shifra. AKEP cakton këto numra drejtpërdrejtë për ofruesit e shërbimeve të numrave blu.

Neni 34
Numrat për shërbimet me vlerë të shtuar (900$X_1X_2X_3$)

Numrat për shërbimet me vlerë të shtuar janë caktuar për shërbimet, ku ofruesi i shërbimit merr një pjesë të pagesave me pakicë. Numrat për shërbimet me vlerë të shtuar përbëhen nga kodi i aksesit **900** dhe numri i pajtimtarit me 3 (tri) shifra. Gjatësia e përgjithshme e një numri për shërbimet me vlerë të shtuar është 6 (gjashtë) shifra. AKEP cakton këto numra drejtpërdrejtë për ofruesit e shërbimeve me vlerë të shtuar.

Neni 35
Numrat e shkurtër për shërbimet SMS me vlerë të shtuar (5$X_1X_2X_3X_4$)

Numrat e shkurtër për shërbimet SMS me vlerë të shtuar janë përcaktuar për shërbimet me vlerë të shtuar në bazë të mesazheve tekst(SMS) ose mesazheve multimedialë (MMS), ku ofruesi i shërbimit merr një pjesë të tarifës me pakicë të paguar. Numrat e shkurtër për shërbimet SMS me vlerë të shtuar kanë një gjatësi prej 5 (pesë) shifrash dhe fillojnë me shifrën **5** dhe nuk duhet të përdoren për shërbimet zanore. AKEP cakton këto numra drejtpërdrejtë për ofruesit e këtij shërbimi.

Neni 36
Rregulla për shërbimet me vlerë të shtuar

1. Të gjithë operatorët e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve publike dhe ofruesit e shërbimeve me vlerë të shtuar duke përfshirë shërbimet SMS me vlerë të shtuar duhet të ndjekin rregullat e përcaktuara në këtë nen.

2. Ofruesit e shërbimeve me vlerë të shtuar, gjatë promovimit të shërbimeve të tyre duhet të japin një përshkrim të shërbimit dhe çmimin e tij në një mënyrë të duhur dhe lehtësisht të kuptueshme. Mashtrimi i përdoruesve duke dhënë informacion fals ose të gabuar ose duke fshehur informacione të rëndësishme, si çmimi i shërbimeve ose kufizime të shërbimit për shkak të moshës është i denueshëm.

3. Numrat për shërbimet me vlerë të shtuar dhe kodet e shkurtër për shërbimet SMS nuk duhet të reklamohen nga thirrje apo mesazhe të pakërkuara dhe nuk duhet të përdoren për identifikimin e linjës thirrëse (CLI).

4. Marrëdhënia me përdoruesin për shërbimet me vlerë të shtuar rregullohet nga legjislacioni në fuqi për komunikimet elektronike, mbrojtjen e konsumatorit, kontratat në distancë, tregtinë elektronike dhe të dhënat personale. Kjo rregullore nuk prezumon krijimin e një kontrate të veçantë kur një përfundim i tillë nuk rrjedh nga ligji dhe nga pëlqimi i vlefshëm i përdoruesit.

5. Ofruesit e shërbimeve me vlerë të shtuar duhet të sigurojnë që çmimi për thirrjen e shërbimit me vlerë të shtuar njoftohet pa pagesë në fillim të çdo thirrjeje dhe që është i mundur përfundimi i thirrjes pas njoftimit brenda një periudhe kohe të arsyeshme para se të fillojë llogaritja e kohës së paguar. Ofruesit e shërbimeve me vlerë të shtuar SMS duhet të informojnë pa pagesë për çmimin e shërbimit para dhënies së shërbimit dhe mund ta japin shërbimin vetëm nëse përdoruesi ka konfirmuar këtë mesazh.

6. Ofruesit e shërbimeve me vlerë të shtuar do të ndërpresin automatikisht thirrjet drejt shërbimit me vlerë të shtuar pas një kohëzgjatjeje prej 15 minutash. Ofruesit e shërbimit SMS me vlerë të shtuar duhet të ofrojnë një mundësi për të ndaluar marrjen e shërbimit në çdo kohë, pa pagesë. Për çdo vlerë prej 500 lekë të akumuluar për SMS të dërguara ose të marra në mënyrë të vazhdueshme, për të përfituar shërbimin me vlerë të shtuar, ofruesi ka detyrimin të njoftojë përdoruesin pa pagesë për vlerën dhe do të vazhdojë të ofrojë shërbimin vetëm nëse përdoruesi e konfirmon këtë mesazh.

7. Ankesat për faturimin, përmbajtjen ose cilësinë e shërbimeve me vlerë të shtuar trajtohen sipas rregullores së AKEP-it për mbrojtjen e konsumatorit dhe legjislacionit në fuqi. Operatori dhe ofruesi i shërbimit bashkëpunojnë që përdoruesi të ketë një pikë të qartë kontakti dhe një zgjidhje të plotë të ankesës.
   a) Marrëveshja ndërmjet operatorit dhe ofruesit të shërbimit përcakton përgjegjësitë, afatet e shkëmbimit të informacionit dhe mekanizmin e rimbursimit, pa kufizuar të drejtat e përdoruesit ose kompetencat e AKEP-it.
   b) Operatori i shërbimit telefonik publik nuk kërkon pagesën e shumës së diskutuar, lëshon një faturë të korrigjuar dhe i dorëzon ankesën si dhe emrin dhe adresën e pajtimtarit dhe detajet e thirrjeve të diskutuara (datën, kohën dhe kohëzgjatjen, numrin thirrës dhe numrin e thirrur) ofruesit të shërbimit (SMS) me vletë të shtuar. Ofruesi i shërbimit (SMS) me vlerë të shtuar më pas duhet të lëshojë një faturë të veçantë për shërbimet e tij dhe duhet të shqyrtojë vetë të gjitha ankesat.

Neni 37
Prefiksi për zgjedhjen e bartësit ($10X_1X_2$)

1. Prefikset për zgjedhjen e bartësit janë përcaktuar për zgjedhjen e operatorit që do të faturojë thirrjen. Prefikset për përzgjedhjen kanë 4 (katër) shifra dhe fillojnë me shifrën **10**.

2. AKEP cakton drejtpërdrejt prefikset individuale për zgjedhjen e bartësve për operatorët e shërbimeve telefonike publike të cilat kanë si qëllim të ofrojnë shërbime të zgjedhjes së bartësit në rrjetin telefonik publik të një operatori tjetër.

Neni 38
Prefikset e rrugëzimit për portabilitetin e numrit ($99X_1X_2$)

1. Prefikset e rrugëzimit për portabilitetin e numrit janë përcaktuar për të ndihmuar rrugëzimin e thirrjeve ndërmjet operatorëve për sa i përket portabilitetit të numrit. Prefikset e rrugëzimit për portabilitetin e numrit kanë 4 (katër) shifra dhe fillojnë me **99**.

2. AKEP cakton prefikset individuale të rrugëzimit për portabilitetin e numrit për operatorët e shërbimeve të disponueshme për publikun.

KAPITULLI IV
PLANET E TJERA NUMERIKE

Neni 39
Formati dhe kapaciteti i numrave NSPC dhe ISPC

1. NSPC-të janë të vlefshme vetëm në rrjetin e sinjalizmit ndërmjetës kombëtar të përcaktuar me NI = 10 (simbol binar). Për identifikimin e pikave të sinjalizimit kombëtar përdoret formati 14 bit kod binar. Pra me 14 bite mund të krijohen 2^{14} = 16384 kode NSPC. NSPC-

të janë përfaqësuar nga shifra a-b-c, ku "a" ka një vlerë 0 deri në 7, "b" ka një vlerë 0 deri në 15 dhe "c" ka një vlerë 0 deri në 127 dhe e paraqitur në bit: a (3 bit), b (4 bit) dhe c (7 bit) dhe shënohet formati 3-4-7.

Kodi i Pikave të Sinjalizimit Kombëtar		
N M L	**K J I H**	**G F E D C B A**
3 bit	4 bit	7 bit

Këto pjesë të formatit të NSPC kanë vetëm një qëllim, përdorim administrativ dhe ata nuk mund të përdoren për protokolle ose funksione sinjalizimi të tjera.

2. Bazuar në rekomandimin Q.708 të ITU struktura dhe formati i kodit për pikën e sinjalizimit ndërkombëtar (ISPC) është si më poshtë. ISPC-të janë të vlefshme vetëm në rrjetin e sinjalizmit ndërkombëtar të përcaktuar me NI = 00 (simbol binar). Për identifikimin e pikave të sinjalizimit ndërkombëtar përdoret formati 14 bit kod binar. Pra me 14 bite mund të krijohen 2^{14} = 16384 kode ISPC. ISPC-të janë përfaqësuar nga shifra a-b-c, ku "a" ka një vlerë 0 deri në 7, "b" ka një vlerë 0 deri në 255 dhe "c" ka një vlerë 0 deri në 7 dhe e paraqitur në bit: a (3 bit), b (8 bit) dhe c (3 bit) dhe shënohet: formati 3-8-3.

Kodi i Pikave të Sinjalizimit Ndërkombëtar		
Kodi i rrjetit për sinjalizimin e zonës (SANC)		**Pika e sinjalizimit**
N M L	**K J I H G F E D**	**CBA**
3 bit	8 bit	3 bit

Neni 40
Caktimi i Kodeve të Pikave të Sinjalizimit

1. Të drejtën për të përdorur Kode të Pikave të Sinjalizimit NSPC (Kombëtare) dhe ISPC (Ndërkombëtare) e ka çdo operator i rrjetit të komunikimeve elektronike publike kur vepron në përputhje me këto rregulla.

2. Operatorët nuk kanë asnjë të drejtë pronësie mbi Kodet e Pikave të Sinjalizimit që u janë caktuar.

3. NSPC-të përdoren për rrjetet e sinjalizimit kombëtar. Rrjeti i sinjalizimit kombëtar karakterizohet nga NI=10 (simbol binar). Për të përdorur NSPC mund të aplikojnë të gjithë operatorët e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike të cilët përdorin sinjalizimin SS7. Këto rregulla nuk do të aplikohen për kodin NI=11 (simbol binar) i cili mund të jetë i lirë për tu përdorur nga operatorët pa përcaktim paraprak.

4. AKEP-i vendos për kërkesën e plotë për caktimin e kodit NSPC ose ISPC brenda tri javëve, sipas nenit 132 të ligjit nr. 54/2024. Kërkesa për plotësim dhe çdo zgjatje lejohen vetëm në rastet dhe brenda kufijve të parashikuar nga ligji.

5. Një ISPC e rrjedhur nga një SANC (Signalling Area/Network Code) caktuar Shqipërisë, përdoret brenda Shqipërisë.

6. Përdorimi i një ISPC që rrjedh nga SANC, caktuar një vendi tjetër, kërkon që të sigurohet nga Autoriteti përkatës i vendit në fjalë një aprovim me shkrim.

7. Një pikë sinjalizimi identifikohet me një kod NSPC ose ISPC. E drejta e përdorimit nuk transferohet pa miratimin paraprak të AKEP-it sipas nenit 12 të kësaj rregulloreje.

8. Çdo transferim i një kodi ISPC, përfshirë në rast bashkimi, përthithjeje, blerjeje ose riorganizimi, kërkon miratimin paraprak të AKEP-it. Njoftimi i thjeshtë nuk zëvendëson vendimin e miratimit dhe nuk prodhon efekt mbi të drejtën e përdorimit.

9. Operatorët njoftojnë AKEP, jo më vonë se 15 ditë për çdo ndryshim në të dhënat për kodet e sinjalizimit të përdorura prej tyre.

10. AKEP njofton ITU për ISPC- të e caktuara/revokuara brenda 90 ditëve nga miratimi i tyre.

Neni 41
Kriteret e vlerësimit të Kodeve të Pikave të Sinjalizimit

1. Operatorët janë të detyruar të sigurojnë informacionin e mëposhtëm gjatë procesit të aplikimit për kode:
   a) Emri dhe detaje të kontaktit të operatorit, duke specifikuar emrin e plotë të regjistrimit dhe adresën postare të regjistruar të biznesit, emrin dhe personin përgjegjës të kontaktit, dhe numrin e telefonit, faks-it dhe adresën e email-it.
   b) kur një person paraqet një formular aplikimi në emër të një operatori, duhet ta shoqërojë atë me një autorizim të nënshkruar dhe datuar nga operatori.
   c) Emri unik i pikës së sinjalizimit mund të përfshijë edhe vendodhjen.
   d) Natyra e përdorimit në rrjet
   e) Prodhuesi/tipi i pikës së sinjalizimit
   f) Adresa fizike e pikës së sinjalizimit
   g) Data e vënies në shërbim të pikës së sinjalizimit
   h) Për ISPC: identifikimi i MTP të planifikuar për të paktën një lidhje sinjalizimi e cila përfshin: Emrin, adresën, vendodhjen dhe ISPC-në e pikës së sinjalizimit në distancë.
2. Kur aplikimi është i pasaktë ose i paplotë, AKEP-i kërkon korrigjimin ose plotësimin e tij sipas pikës 4 të nenit 10 dhe Kodit të Procedurave Administrative.

Neni 42
Revokimi i Kodeve të Pikave të Sinjalizimit

1. AKEP-i mund të revokojë të gjithë ose një pjesë të kapacitetit të caktuar vetëm sipas shkaqeve dhe procedurës së nenit 13 të kësaj rregulloreje, kur konstatohet se:
   a) Kodi i Pikës së Sinjalizimit nuk vendoset në shërbim brenda kohës së specifikuar në afatin kohor.
   b) Kodi i Pikës së Sinjalizimit është përdorur për qëllime të ndryshme nga ato të specifikuara në formularin e aplikimit.
   c) Operatori nuk e përdor më Kodin e Pikës së Sinjalizimit për një afat 3 vjeçar.
   d) Kodi i Pikës së Sinjalizimit është përdorur nga një operator tjetër pa miratimin e AKEP.

e) Operatori është çregjistruar ose ka pezulluar aktivitetin në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

2. Revokimi i Kodit të Pikës së Sinjalizimit mund të bëhet me nismën e Autoritetit ose me kërkesën e zotëruesit.

3. Autoriteti njofton zotëruesin e kodit për nisjen e procedurës së revokimit.

4. Ndërkohë ndryshimi i Kodit të Pikës së Sinjalizimit mund të bëhet me nismën e Autoritetit ose me kërkesën e zotëruesit. Në këtë rast aplikohet vetëm pagesa për caktimin e kodit të ri.

Neni 43
Kodet e rrjeteve mobile

1. Bazuar në rekomandimin e ITU E.212 struktura dhe formati i Identitetit ndërkombëtar të parapaguesit mobil (IMSI) përbëhet nga 3 pjesë kryesore.

IMSI		
MCC	**MNC**	**MSIN**
3 shifra	2 deri në 3 shifra	Maksimumi 10 shifra

2. Sipas rekomandimit E.212 kodet shtetërore mobile (*MCC- Mobile Country Code*) administrohen nga ITU, kodet e rrjeteve mobile (*MNC- Mobile Network Code*) nga Administratat e shteteve respektive (Autoriteti), ndërsa pjesa e mbetur, pra MSIN (*Mobile Subscription Identification Number*) menaxhohet nga operatorët, të cilëve u janë caktuar MNC nga AKEP.

3. AKEP është përgjegjës për përcaktimin e kritereve dhe kushteve për caktimin dhe revokimin e kodeve MNC në nivel kombëtar, në përputhje me parimet e ITU-T E.212.
4. Blloqet, të cilat do të jenë në dispozicion për t'u caktuar operatorëve për ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike mobile do të fillojnë nga MCC MNC: 276 01 deri 276 09. Në rast se paraqitet nevoja për kode shtesë, Autoriteti mund të caktoj kodet nga 276 10 e tutje.
5. Aplikuesi duhet të demonstrojë nevojën për burime numerike dhe të argumentojë se alternativat teknike dhe operacionale nuk janë të përshtatshme, duke bashkëngjitur dokumentacionin përkatës.

6. AKEP-i mund të caktojë një kod tjetër nga ai i preferuar vetëm për arsye objektive të administrimit efikas. Refuzimi bëhet vetëm për shkaqet e nenit 132 të ligjit nr. 54/2024 dhe arsyetohet. Si rregull caktohet një MNC; kodi shtesë jepet vetëm kur nevoja, përdorimi dhe mungesa e një alternative teknike provohen.

7. Autoriteti do të njoftoj ITU-në për çdo caktim, ndryshim apo revokim të kodeve brenda nëntëdhjetë (90) ditëve nga data e caktimit/revokimit.

Neni 44
Kodet Identifikuese IIN (Issuer Identifier Numbers)

1. Në përputhje me procedurat e specifikuara në Rekomandimin e ITU-së E.118 operatorët e telefonisë mobile, pas caktimit të kodeve MCC MNC nga AKEP do të aplikojnë për numrin IIN (Issuer Identifier Number).

2. Numri IIN përbëhet prej maksimum 19 shifrave, ku 2 shifrat e para janë 89 dhe përcaktojnë identifikuesin e industrisë së telekomunikacionit, pastaj kodi shtetëror sipas rekomandimit ITU-T E.164, i cili për Republikën e Shqipërisë është 355.

3. AKEP, për çdo caktim ose revokim të këtyre kodeve duhet të njoftojë ITU në përputhje me procedurat dhe afatet kohore të specifikuara në Rekomandimin përkatës të ITU-së.

KAPITULLI V
DISPOZITA KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 45
Përputhshmëria me Planin e Numeracionit

